



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**  
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA E DEÇANIT**  
**MUNICIPALITY OF DEÇAN**  
**OPSTINA DEÇAN**



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime  
Publike

Nr.09 /2022

Dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2022

## **RREGULLORE PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE**

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja f) dhe p) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, 28/2008), dispozitave të Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe nenit 8 paragrafi a) dhe b), neni 15 paragrafi 6) të Statutit të Komunës së Deçanit, nr. 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, me datën \_\_\_\_\_ miraton këtë:

### **RREGULLORE PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE**

#### **I. Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim trajtimin e ofrimit të shërbimeve publike komunale, përmirësimin e kushteve jetësore të qytetarëve, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe pamjes sa më të bukur të qytetit dhe vendbanimeve tjera.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe sanksionet kundërvajtëse me gjobë për personat fizik, personat juridik, në lëmin e shërbimeve publike në territorin e Komunës së Deçanit .

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

.....  
...

### **Neni 4**

#### **Shërbimet publike komunale**

1. Shërbimet publike komunale, në vështrim të kësaj Rregullore konsiderohen:
  - 1.1.furnizimi me ujë;
  - 1.2.përcjellja dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike;
  - 1.3.rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara publike;
  - 1.4.pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime;
  - 1.5.bartja, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave;
  - 1.6.mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike;
  - 1.7.ndriçimi publik;
  - 1.8.rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive dhe
  - 1.9.sinjalizimi dhe numërimi i rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike.
2. Mirëmbajtja e përmendoreve, shtatoreve, busteve, simboleve, varrezave dhe transporti lokal rregullohen me rregullore të veçanta.

### **Neni 5**

#### **Objektet komunale**

1. Objekte komunale -publike në vështrim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:
  - 1.1. rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha pajisjet përcjellëse;
  - 1.2. rrugët, trotualet dhe sheshet;
  - 1.3. hapësirat për parking;
  - 1.4. sipërfaqet publike të gjelbëruara;
  - 1.5. terrenet sportive;
  - 1.6. përmendoret shtatore, bustet, simbolet dhe varrezat;
  - 1.7. rrjeti i ndriçimit publik me stabilimentet përcjellëse;
  - 1.8. linjat telefonike, elektrike dhe kablllovice;
  - 1.9. njejt sanitare publike;
  - 1.10. tabelat për shpallje;
  - 1.11. objektet reklamuese – panot, reklamat dhe
  - 1.12. të gjitha objektet tjera të cilat, sipas destinimit që kanë, mund të konsiderohen objekte komunale. (te ceken cilat objekte përfshihen)

### **Neni 6**

#### **Shfrytëzimi i objekteve komunale**

1. Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar sipas (sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje mund të

formulohet edhe ndryshe...), duke pasur parasysh se pamja dhe gjendja e këtyre objekteve duhet të jenë në funksion të pamjes sa më të bukur të qytetit.

2. Qytetarët, subjektet dhe të gjithë shfrytëzuesit e objekteve, janë të detyruar të kujdesen për realizimin e mbrojtjes së objekteve, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

## **Neni 7**

### **Ujësjiellësi dhe kanalizimi**

1. Ndërmarrja e ujësjiellësit dhe kanalizimit, detyrë e të cilës është furnizimi i rregullt i qytetarëve me ujë të pijshëm, përpunimi, pastrimi dhe përcjellja e ujërave të zeza dhe atmosferike, bënë shfrytëzimin si dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve të parapara sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje, gjegjësisht:
  - 1.1.bënë mirëmbajtjen dhe sigurimin e të gjitha objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit;
  - 1.2.bënë kontrollimin e përhershëm të cilësisë së ujit për pije, sigurimin e pandërprerë të rregullt dhe higjienike-teknik sipas dispozitave ligjore për këtë lëmi;
  - 1.3.bënë ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve, pajisjeve dhe të instalimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit;
  - 1.4. jep kushtet për sigurimin e lidhjes në rrjetin e ujësjiellësit dhe të kanalizimit, dhe
  - 1.5.bënë pastrimin e të gjitha pusëve akumuluese për ujëra atmosferike dhe ujërave të zeza, së paku dy herë në vit (në muajin prill dhe tetor).
2. Ndërmarrja, nga paragrafi 1 i këtij neni, të gjitha objektet si dhe instalimet e ujit dhe të kanalizimit, i mirëmban në pajtim me këtë rregullore dhe ligjet në fuqi dhe është e detyruar që t'i mbajë si mjete themelore të veta në shfrytëzim.

## **Neni 8**

### **Mbikëqyrja e cilësisë së ujit**

1. Mbikëqyrjen e cilësisë së ujit e bënë organi kompetent sanitar, sipas dispozitave ligjore dhe i ndërmerr masat me të cilat sigurohet cilësia e kërkuar.
2. Vlerësimin për cilësinë e ujit mund ta jep laborator i ndërmarrjes publike për ujë dhe kanalizim dhe Enti i autorizuar shëndetësor. (instituti kombëtar i shëndetit publik).

## **Neni 9**

### **Shfrytëzuesit e ujit jashtë rrjetit të ujësjiellësit publik**

Të gjithë shfrytëzuesit e ujit të pijshëm të cilët ujin e marrin nga pusët (të cekëta ose të thella) në forma tjera nga burimet e ndryshme (qoftë me pompa ose gravitacion) në vendbanimet ku ekziston rrjeti qendror i ujësjiellësit, duhet të lidhen në rrjetin publik të ujësjiellësit në afat prej një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje.

## **Neni 10**

### **Sigurimi i ujit të pijshëm**

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që shfrytëzuesve t'u sigurojë rregullisht ujë të pijshëm dhe me kualitet si dhe rrjet funksional të kanalizimit.
2. Obligimet nga paragrafi paraprakë pushojnë përkohësisht në këto raste:
  - 2.1. të veprimt të fuqisë madhore;
  - 2.2. të pengesave të jashtëzakonshme teknike të bëra pa fajin e ndërmarrjes;
  - 2.3. të punëve të rregullta ose të jashtëzakonshme për përmirësimin e njejeve të ujësjellësit e të kanalizimit;
  - 2.4. të kryerjes së punëve të reja ose rikonstruktimit të pajisjeve të ujësjellësit e të rrjetit të kanalizimit.
3. Për të gjitha këto raste të furnizimit jo të rregullt me ujë, ndërmarrja të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar, që përmes mjeteve të informimit publik, t'i njoftojë shfrytëzuesit mbi shkaqet dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes së ujit.
4. Me rastin e ndërprerjeve lokale të planifikuara më parë të furnizimit me ujë, shfrytëzuesit duhet të njoftohen së paku 24 orë më herët me datën, kohën dhe zgjatjen e ndërprerje.
- 5.

## **Neni 11**

### **Furnizimi me ujë**

1. Çdo objekt publik, kolektiv dhe individual, do të jetë i furnizuar me ujë nga ujësjellësi publik i qytetit dhe patjetër ta ketë lidhjen e veçantë të ujësjellësit-ujëmatësin dhe rrjetin e veçantë të kanalizimeve.
2. Me rastin e ndërtimit të rrjetit të ri të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe rikonstruktimit të rrjetit ekzistues, investitori është i obliguar që, përveç linjës kryesore të ujësjellësit, t'i kryejë edhe lidhjet deri te linja kryesore e rregulluar në bazë të planit urbanistik.
3. Këto punë duhet t'i kryejë ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit.

## **Neni 12**

### **Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit**

1. Ndërtimin e rrjetit të ri nëpër rrugë, në të cilat ekzistojnë përcjellësit kryesorë të ujësjellësit dhe të kanalizimit, me kërkesën e investuesit, kryesisht i kryen ndërmarrja për ujësjellës dhe kanalizim, ose nën mbikëqyrje të saj.
2. Ndërmarrja nga paragrafi paraprakë, obligohet që gjatë ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit t'u përmbahet dispozitave sanitare-teknike mbi vënien e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.
3. Ndërmarrja nga paragrafi 1 këtij neni, është përgjegjëse për cilësinë e të gjitha llojeve të punëve rreth lidhjes (instalimit) me rrjetin gjegjës.

### **Neni 13**

#### **Instalimet e rrjeteve**

1. Instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit lidhen në ujësjellës dhe kanalizim, me anë të pajisjeve adekuate të rrjetit.
2. Vënia e nyjave përcjellëse nënkupton bashkimin i rrjetit publik të ujësjellësit deri te ujëmatësi, respektivisht prej rrjetit rrugor deri te linja e rregullacionit.
3. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, do të mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, bashkë me nyjat përcjellëse të ujëmatësit, respektivisht deri te objekti i parë akumulues i pusëtës.
4. Ndërmarrja nga paragrafi paraprakë, është e obliguar që ta mirëmbajë në gjendje të rregullt edhe ventilin e parë të ujëmatësit.
5. Çdo objekt i cili kufizohet me rrugët ose sheshin ku është ngritur rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit, duhet të jetë i lidhur në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit përmes nyjave përcjellëse.
6. Pronarët që kanë hidro-pompa dhe ata të cilët furnizohen me ujë në mënyrë jo adekuate, si dhe pronarët e njeve sanitare me grupa septike, janë të obliguar që të lidhen në nyjat e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, gjegjësisht, më së voni, në afatin prej (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 14**

#### **Dokumentacioni teknik**

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, i jep shënimet për përpunimin e dokumentacionit teknik të instalimit dhe të kanalizimit, si dhe të nyjave përcjellëse.
2. Nyjat përcjellëse mund të ngritën në bazë të lejes për ndërtim.
3. Leja nga paragrafi paraprak, lëshohet në bazë të dokumentacionit teknik për objekte e ndërtuara.

### **Neni 15**

#### **Leja për kyçje**

1. Lejen për kyçje në nyjën përcjellëse në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit e lëshon ndërmarrja për ujësjellës dhe kanalizim.
2. Lejen për rrëmbien e rrugëve, trotuareve dhe të sipërfaqeve publike për vënien e nyjave në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, e jep Drejtoria përkatëse.

### **Neni 16**

#### **Detyrimet e ndërmarrjeve**

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e detyruar që ta ndërlidhë ujësjellësin dhe kanalizimin rrugor me pajisjet shtëpiake të ujësjellësit dhe të kanalizimit, nëse këto janë kryer me projektin e lejuar dhe sipas dispozitave dhe kushteve teknike, në afat prej 10 ditësh nga dita e njoftimit se punët përgatitore për lidhje janë kryer.

2. Nëse ndërmarrja nga paragrafi paraprak, nuk e kryen lidhjen me kërkesën e palës, atëherë organi kompetent komunal, këto punë mund t'ia besoj individit tjetër juridik ose fizik të autorizuar për kryerjen e këtyre punëve me shpenzimet e marrësit të shërbimeve.

### **Neni 17**

#### **Shpenzimet e kyçjes**

Shpenzimet e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, i bartin shfrytëzuesit e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

### **Neni 18**

#### **Ndalesat**

Ndalohet kyçja pa leje nga organi kompetent në rrjetin publik të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

### **Neni 19**

#### **Matjet e shpenzimeve të ujit**

1. Matja e ujit të shpenzuar nga rrjeti publik i ujësjellësit, duhet të kryhet vetëm përmes ujëmatësit.
2. Në rast të prishjes së ujëmatësit, ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së tyre, do të caktojë shumën paushall të pagesës së mesatares së tremujorit të fundit, deri të kthehet ujëmatësi i rregulluar.

### **Neni 20**

#### **Pagesat paushallë**

1. Pronarët e objekteve me rrjet të ujësjellësit në të cilin shpenzimet e ujit paguhen paushall, janë të obliguar që në afatin prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, me shpenzimet e veta ta vendosin ujëmatësin në rrjetin e vet, nëse lejojnë kushtet teknike.
2. Nëse shfrytëzuesi i ujëmatësit nuk e vendos ujëmatësin, në afatin e paraparë në paragrafin paraprak të këtij neni, ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit menjëherë do t'ia ndërpresë shfrytëzuesit furnizimin me ujë nga ujësjellësi publik dhe do të kërkojë dëmshpërblimin.

### **Neni 21**

#### **Vendosja e ujëmatësve**

1. Vendosja respektivisht montimi i ujëmatësve apo ndërimi i të vjetërve e bënë ekskluzivisht ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit në afat prej dyzet e pesë (45) ditësh nga dita e paraqitjes nga ana e shfrytëzuesit.
2. Vendosja e ujëmatësve të rinj, riparimi dhe ndërimi i ujëmatësve të vjetër bëhet me shpenzimet e shfrytëzuesve të tyre.

### **Neni 22**

#### **Ruajtja dhe mbikëqyrja e ujëmatësve**

Ujëmatësit duhet të jenë të ruajtur dhe mbikëqyrur sipas standardeve të pranueshme dhe të vendosur në vendet e veçanta dhe të mbyllura, të cilat ndërtohen me shpenzimet e investitorit, respektivisht të pronarit të objektit në bazë të udhëzimeve të ndërmarrjes të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

#### **Neni 23**

##### **Sanimi i prishjeve te ujëmatësve**

Çdo prishje dhe dëmtim të ujëmatësve, konsumatori është i obliguar që menjëherë ta paraqes te ndërmarrja përkatëse dhe e njëjta është e detyruar që këtë prishje dhe dëmtim ta sanojë në afatin prej 24 orësh.

#### **Neni 24**

##### **Shpenzimet e mirëmbajtjes se ujëmatësve**

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe kyçjes në ujësjellës, prej rrjetit të jashtëm të ujësjellësit deri të ujëmatësi i heq ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, kurse të tjerat i heq shfrytëzuesi i ujit.

#### **Neni 25**

##### **Detyrimet e shfrytëzuesve të ujësjellësit**

Shfrytëzuesit e ujësjellësit publik, janë të detyruar që me kohë të ndërmarrin masa që instalimet e shtëpive të mbrohen nga prishjet, ngricat dhe të mbahen gjithnjë në gjendje të rregullt.

#### **Neni 26**

##### **Autorizimi**

Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit është i vetmi autoritet publik kompetent i cili mund të autorizojë kompani për kontrollin dhe mirëmbajtjen ujëmatësve.

#### **Neni 27**

##### **Pagesat**

1. Shpenzimi i ujit paguhet sipas tarifës për 1 m<sup>3</sup> ujë. Sasia e ujit të shpenzuar vërtetohet me anë të ujëmatësit.
2. Pagesa e ujit realizohet përmes faturimit mujor.
3. Për shfrytëzimin e ujit dhe të shërbimeve nga rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit paguhet kompensimi nga ana e konsumatorëve për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimit.
4. Tarifën mbi lartësinë e këtij kompensimi e cakton Autoriteti Rregullativ i Ujësjellësit (ARRU), nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

## **Neni 28**

### **Ndërprerja e Ujit**

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe e kanalizimit do t'i ndërpresë shfrytëzuesit e ujit nga ujësjellësi publik në këto raste:
  - 1.1. kur fatura për ujin e shpenzuar nuk paguhet në afat prej 15 ditësh pas marrjes së vërejtjes me shkrim, se nuk është paguar uji i shpenzuar;
  - 1.2. kur konsumatori paraqet shpërnguljen, ndërsa konsumatori i ri nuk e paraqet ujin e shpenzuar;
  - 1.3. kur meremetimi, pengesat dhe dëmtimet bëhen në rrjetin e ujësjellësit;
  - 1.4. kur instalimi i ujësjellësit i dëmton shfrytëzuesit e vet, përkatësisht cilësia e ujit në rrjetin e ujësjellësit nuk është e mirë;
  - 1.5. nëse gropa e ujësjellësit (vendi ku është bërë lidhja-ujëmatësi) është e ndotur, e mbyllur ose e prishur, ndërsa konsumatori edhe pse i është bërë vërejtja me shkrim nga ndërmarrja, nuk ka ndërmarr veprime për eliminimin e të metave;
  - 1.6. kur dëmtohet apo hiqet bllobla nga ujëmatësi;
  - 1.7. kur vet pronari e rregullon ujëmatësin dhe në
2. Lidhja e serishme bëhet me kompensimin e shpenzimeve nga ana e pronarit.

## **Neni 29**

### **Lirimi nga pagesa**

Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, nuk do të kërkojë kompensim për ujin e shpenzuar nga hidrantët publike që shpenzohen për fikjen e zjarreve.

## **Neni 30**

### **Kujdesi ndaj ujit**

Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që ta pengojë çdo derdhje të ujit pa arsye dhe të kërkojë të ndërmerren masa ndëshkimore në pajtim me këtë rregullore dhe akteve tjera ligjore.

## **Neni 31**

### **Kufizimet dhe zbatimi i urdhëresave**

1. Në raste të thatësisë dhe pengesave tjera të furnizimit me ujin e pijes, ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që të ndërmerr masa teknike të kufizimit të shpenzimit të ujit.
2. Në këto raste ndërmarrja nga paragrafi paraprake do t'i propozojë organeve përkatëse në komunë, që me urdhëresë të veçantë të caktojë mënyrën e shpenzimit të ujit, kufizimin ose ndalimin e shpenzimit të ujit, për disa konsumatorë të caktuar. Urdhëresën e zbaton ndërmarrja për ujë dhe kanalizim dhe drejtoritë përkatëse.

## **Neni 32**

### **Pëlqimi**

1. Përmes hidrantëve të rrjetit të ujësjellësit publik, ujin mund ta marrin vetëm ndërmarrjet dhe subjektet tjera, të cilat për këtë e kanë pëlqimin paraprak nga ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, në koordinim me organin Drejtorisë përkatëse.
2. Njësia e zjarrfikësve ka të drejtë të marrë ujin nga ujësjellësi publik gjatë intervenimit në fikjen e zjarreve.
3. Të gjithë shfrytëzuesit tjerë të ndërmarrjeve apo personat fizik të cilët marrin sasi të caktuara të ujit për kryerjen e ndonjë pune ndërtimore e të ngjashme, duhet patjetër të kenë leje të posaçme nga ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit. Shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i hidrantëve publik, rregullohet me kontratë të posaçme, ndërmjet ndërmarrjes dhe shfrytëzuesit.

## **Neni 33**

### **Mirëmbajtja**

Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e detyruar që rregullisht të mirëmbajë dhe ta bëjë pastrimin e përcjellësve dhe të pusetave për kanalizimin e ujërave fekale në mënyrë që në çdo kohë t'i përgjigjet destinimit të tyre.

## **Neni 34**

### **Riparimet**

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që pas punëve të kryera ndërtimore siç është lidhja, intervenimet në prishje dhe ndërrimit të gypave, terrenin (vendin e punimeve) duhet ta kthejë në gjendje të mëparshme.
2. Obligimi nga paragrafi i mëparshëm bie në barrë të shfrytëzuesit, respektivisht të investuesit, nëse këto punë i kryen vetë (rrëmihja dhe mbulimi i vendit ku është kryer lidhja).
3. Kryesit e punëve (personat juridikë dhe fizik), menjëherë pas kryerjes së punëve, në afatin të cilin e ka caktuar organi kompetent me rastin e dhënies së lejes për lidhje, janë të obliguar që materialin e tepërt ta mënjanojnë nga rrugët, trotualet, sipërfaqet publike dhe terrenin ta kthejnë në gjendjen e mëparshme.

## **Neni 35**

### **Mbrojtja e rrjeteve**

1. Gjatë shfrytëzimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ndalohej:
  - 1.1. hedhja e mbeturinave, hirit, çimentos, rrërës e fundërrinave tjera të ngjashme në rrjetin shtëpiak të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtimin e funksionimit të rregullt të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
  - 1.2. në përcjellësit e ujit të rrugëve të derdhen lëndët e ngurta e materiali tjetër;
  - 1.3. që në ujëmbledhës të hedhen mbeturinat nga pastrimi i oborreve dhe shesheve;
  - 1.4. derdhja në kanalizim të ujit dhe lëngjeve tjera, temperatura e të cilave është më e lartë se 350C ose me përmbajtje të thartirave të dëmshme të alkaleve dhe të kripërave;

- 1.5. derdhja e ujërave fundrinore pa lejen e ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 1.6. hedhja e materialit ndezës i cili mund të shkaktojë zjarr;
- 1.7. parkimi i automjeteve apo vënia e materialit ose mbeturinave në dhe mbi objektet e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 1.8. të bëhet çfarëdo dëmtimi në objektet e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- 1.9. ndalohet ujitja e kopshteve-oborreve dhe
- 1.10. ndalohet derdhja e ujit në rrugë, trotuare me qëllim freskimi

### **Neni 36** **Gjelbërimi publik**

1. Me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe zgjerimit e kultivimit të këtyre sipërfaqeve në territorin e qytetit, vendbanimeve dhe fshatrave, ato në mbikëqyrje dhe në mbrojtje, në mënyrën si është përcaktuar me këtë Rregullore, parashihen:
  - 1.1. sipërfaqet publike të gjelbra: rendet e drunjëve, gjelbërimi i ambientit në lagjet e banimit, gjelbërimi afër rrugëve të trafikut,
  - 1.2. pjesët mbrojtëse të lagjeve në qytet dhe në para lagjet e qytetit, në vendet e banuara dhe në zonat industriale (pjesët mbrojtëse të gjelbërimit dhe të sipërfaqeve tjera ujore), përveç tokës dhe mbrojtëse pyjor, e cila është pjesë përbërëse e sistemit për mbrojtje nga vërshimet;
  - 1.3. sipërfaqet e gjelbra të ndërmarrjeve, organizatave e subjekteve tjera;
  - 1.4. sipërfaqet e gjelbra me destinim të veçantë dhe të dobishëm (gjelbërimi rreth varrezave, rreth objekteve kulturore historike dhe objekteve tjera me rëndësi);
  - 1.5. sipërfaqet e gjelbra për sport dhe rekreacion (oborret e shkollave, ushtrimoret, terrenet sportive, qendrat, vendet për rekreacion e të ngjashme) dhe objekteve komunale;
  - 1.6. gjelbërimi i oborreve të shtëpive, të vendeve për vikend, hapësirave të kampeve, lokaliteteve turistike dhe shëtitoreve.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokën bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat aplikohen dispozita të veçanta.

### **Neni 37** **Kontrolli**

1. Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e porsandërtuara, parashihet me projektet e ndërtimeve të reja dhe bëhet me anë të kontrollit profesional të organit kompetent të Komunës.
2. Zgjerimi dhe ngritja e sipërfaqeve të reja, bëhet me anë të projektit mbi ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve të reja në harmoni me planin rregullues urban.

### **Neni 38** **Planifikimet**

1. Projektet e të gjitha objekteve që do të ndërtohen në pjesën e Komunës, në vete duhet të përfshijnë edhe planet dhe skicat e tokës për gjelbërim, të cilat sipas lokacioneve u takojnë atyre objekteve.

2. Projektet të cilat nuk i kanë planet - skicat për gjelbërim, do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të lejohen.
3. Nëse lejohet ndërtimi në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përgjegjësia bie mbi organin i cili e ka lëshuar lejen ndërtimore.

### **Neni 39**

#### **Harmonizimi i planeve**

Të gjitha planet - skicat e gjelbërimit duhet të jenë të harmonizuara me planin e gjelbërimit të Komunës, respektivisht me konceptet e planeve rregulluese urbane, për të cilat duhet të kujdeset projektuesi, respektivisht investuesi.

### **Neni 40**

#### **Punimet**

1. Investuesit janë të detyruar t'i kryejnë punimet rreth gjelbërimit të tërësishëm të lokacioneve, para se të bëhet pranimi teknik i punëve ndërtimore dhe të punëve të tjera nëpër objekte investive.
2. Komisioni për pranimin teknik të objekteve, është i detyruar që njëkohësisht të bëjë pranimin teknik të punëve të gjelbërimit.
3. Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt në tokën e urbanizuar ndërtimore, shfrytëzuesi do t'i gjelbërojë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, më së voni në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

### **Neni 41**

#### **Marrja e pëlqimit**

Shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar që të marrin pëlqimin e organit kompetent komunal, para se ta bëjë gjelbërimin e sipërfaqeve të parapara me këtë rregullore.

### **Neni 42**

#### **Mbrojtja e sipërfaqeve publike**

1. Punët rreth gjelbërimit, siç janë: Kultivimi i drunjëve, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sipërfaqeve publike dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, i kryejnë pronarët dhe ndërmarrja kompetente.
2. Të drejtat dhe obligimet lidhur me kryerjen e punëve nga paragrafi paraprak, do të rregullohen me kontratë.

### **Neni 43**

#### **Afati i gjelbërimit**

1. Nëse shfrytëzuesit e tokës nuk e bëjnë gjelbërimin në afatin e caktuar sipas nenit ..... , organi kompetent i komunës do ta urdhërojë ndërmarrjen kompetente, që ta bëjnë gjelbërimin me shpenzimet e shfrytëzuesit.

2. Shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra publike jashtë destinimeve të tyre themelore, mund të bëhet në rastet kur këtë e kërkon interesi publik, me pëlqimin/lejen e organit kompetent komunal.

#### **Neni 44**

#### **Vendosja e shportave për mbeturina**

Ndërmarrja kompetente është e obliguar që nëpër rrugë, parqe, sheshe dhe vende tjera publike, të vendosë dhe të mirëmbajë shportat për mbeturina të imta dhe të ulëseve për pushim.

#### **Neni 45**

#### **Instalimet nëntokësore**

Vendosja e instalimeve nëntokësore (objekteve të ujës-jellësit dhe të kanalizimit, linjat elektrike, telefonike e të ngjashme) në sipërfaqet e gjelbra, bëhet në distancë prej 2m nga fidani ekzistues, por me lejen paraprake nga organi i administratës, për hapjen e tyre dhe duke obliguar investuesin që ta kthejë në gjendjen e mëparshme, sipas kushteve të përcaktuara në leje dhe në projekt.

#### **Neni 46**

#### **Detyrimet e ndërmarrjes lidhur me mirëmbajtjen e gjelbërimit**

1. Ndërmarrja kompetente për mirëmbajtjen e gjelbërimit është e obliguar:
  - 1.1. që menjëherë t'i largojë të gjitha pengesat për shkak të ndikimit të kushteve natyrore atmosferike ose nga shkaktarët tjerë;
  - 1.2. që barin e kositur si dhe materialin e mbetur ta largojë nga sipërfaqet e gjelbëruara publike.

#### **Neni 47**

#### **Evitimi i pengesave**

Degët e rritura të drunjëve në sipërfaqet e gjelbra publike, të cilat pengojnë kabllot ajrore (rrjetin elektrik, telefonit e të ngjashme) duhet të shkurtohen ose të evitohen vetëm nga ana e ndërmarrjes së cilës i besohen punët dhe e cila është e obliguar të pajiset me leje nga organit kompetent komunal.

#### **Neni 48**

#### **Vlerësimi i dëmeve**

Dëmet e bëra në sipërfaqet e gjelbëruara nga ana e personave juridik dhe fizik, me kërkesën e ndërmarrjes së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, do të vlerësohen nga ana e komisionit të cilën e emëron organi kompetent komunal për shërbimet komunale.

#### **Neni 49**

## **Njoftimet lidhur me respektimin e hapësirave gjelbëruese**

Ndërmarrja kompetente për mirëmbajtjen e gjelbërimit me lejen e organit kompetent është e obliguar që në vend të dukshëm, t'i vendos vërejtjet apo ndalesat të cilat kanë të bëjnë me këto sipërfaqe.

### **Neni 50 Veprimet e ndaluara**

1. Në sipërfaqet e gjelbëruara publike ndalohet:
  - 1.1. këputja, shkulja dhe prerja e drunjëve dekorativ, barit dhe bimëve të tjera, thyerja e degëve apo fidanëve e të ngjashme;
  - 1.2. vozitja dhe parkimi i automjeteve (i të gjitha llojeve) si dhe shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali në këto sipërfaqe;
  - 1.3. dëmtimi i ulëseve, shportave, rekuizitave, kalimi për këmbësorë jashtë shtigjeve, hidrantëve dhe instalimeve tjera;
  - 1.4. largimi, djegia, dëmtimi i shenjave dhe mbishkrimeve paralajmëruese.
  - 1.5. shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe të tjera të gjelbëruara jashtë destinimeve të tyre themelore ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to pa lejen e veçantë;
  - 1.6. vendosja dhe derdhja e çfarëdo lënde dhe materiali nëpër drunjë dhe në pjesët tjera, pa lejen e organit kompetent për punët komunale;
  - 1.7. rrëzimi dhe zhvendosja ulëseve, rekuizitave sportive, rrethojave e të ngjashme;
  - 1.8. shtrirja dhe qëndrimi nëpër sipërfaqe të gjelbëruara;
  - 1.9. lëvizja jashtë rrugicave të shënuara për këmbësor;
  - 1.10. lëshimi i ujërave të zeza nëpër parqe dhe sipërfaqe tjera publike;
  - 1.11. keqpërdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësendeve, turbullimi i ujit dhe hedhja e fundërrinave e mbeturinave tjera);
  - 1.12. guajtja e shpezëve dhe kafshëve jashtë vendeve dhe kohës së caktuar;
  - 1.13. kositja dhe largimi i barit nga sipërfaqet e gjelbëruara pa lejen e organit kompetent për punë komunale;
  - 1.14. vendosja e vendosja e luna-park, cirkut dhe rekuizitave tjera, pa lejen e organeve kompetente komunale;
  - 1.15. shfrytëzimi shfrytëzimi për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake;
  - 1.16. ndezja e zjarreve dhe djegia e gjetheve në ambiente të hapura me qëllim ose nga pakujdesia;
  - 1.17. hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave të tjera;
  - 1.18. mihja, hapja e puseve, mbjellja e drunjëve etj për çfarëdo destinimi, pa u pajisur me leje nga organi kompetent komunal.
2. Veprimet e ndaluara në paragrafin 1 të këtij neni, vlejnë edhe kur bëhet fjalë për pronën private.

### **Neni 51 Sipërfaqet publike**

1. Sipërfaqet publike, sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen ato sipërfaqe, në të cilat është i lejuar qëndrimi i pakufizuar i personave, siç janë:

- 1.1. sipërfaqet e trafikut publik (rrugët dhe sipërfaqet tjera për trafik, trotualet, rrugicat dhe sipërfaqet tjera publike);
- 1.2. stacionet e autobusëve, vendqëndrimet, depot e karburantit dhe hapësirat për parkim;
- 1.3. sipërfaqet publike dhe të gjelbra, (parqet, sheshet e vogla, drurët, sipërfaqet me bari, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion);
- 1.4. terrenet argëtuese dhe sportive (stadiumet, fushat e sportit, çerdhet, etj);
- 1.5. sipërfaqet me ujë (brigjet afër lumit, pishinat) etj;
- 1.6. tregjet (tregjet e gjelbëruara, të bulmetit dhe të kafshëve), vendet për grumbullimin e prodhimeve bujqësore, të qumështit dhe të kafshëve;
- 1.7. sipërfaqet e hapura ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe tokat e pa ndërtuara (trojet, vendet për shkarkim dhe oborret, fasadat, kulmet e ndërtesave të banimit);
- 1.8. sallat e kinemave, teatrove dhe të tjera, të cilat shërbejnë për tubime publike të qytetarëve;
- 1.9. varrezat dhe hyrjet në varreza.

## **Neni 52**

### **Rrugët**

Rrugët janë sipërfaqe publike sipas përkufizimit të Ligjit për rrugët.

## **Neni 53**

### **Mirëmbajtja e rrugëve**

1. Rrugët mirëmbahen në gjendje të rregullt dhe shfrytëzohen sipas destinimit të tyre.
2. Ndërmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, është e obliguar që të gjitha dëmtimet nëpër rrugët e trafikut dhe trotualet t'i evitojë, si dhe t'i mbajë ato në gjendje të rregullt.

## **Neni 54**

### **Kufizimi i lëvizjeve të automjeteve**

1. Në sipërfaqet e rrugëve të shtruara me shtresën e asfaltit, ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve transportuese dhe të tjera të cilat mund të dëmtojnë rrugën, siç janë: makinat me zinxhirë, llojet e ndryshme të makinave ndërtimore dhe mjetet tjera të ngjashme.
2. Transporti i makinave dhe i mjeteve tjera që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese të veçanta. Njëherësh, ndalohet qarkullimi i automjeteve me peshë të rëndë mbi peshën e lejuar në ato rrugë.

## **Neni 55**

### **Trotualet**

1. Trotualet janë sipërfaqe publike të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.
2. Shiriti i rrugës shfrytëzohet për lëvizjen e mjeteve të komunikacionit.

3. Sipërfaqet e tjera publike si: sheshet, sheshet e vogla, parqet dhe të ngjashme, shfrytëzohen në bazë të destinimit të tyre.

#### **Neni 56**

##### **Ndalimi i shitjeve në trotuare dhe sheshe**

Në sipërfaqet e trotuareve dhe të shesheve të vogla publike, nuk lejohet shitja dhe vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtarie pa lejen e organeve kompetente komunale.

#### **Neni 57**

##### **Leja për ngarkim dhe shkarkim të mallit**

1. Shkarkimi i mallit nëpër trotuare, bëhet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet nëpër oborret e ndërtesave, respektivisht të hapësirave punuese.
2. Malli duhet të largohet menjëherë nga trotuari, e më së voni në afat prej një ore, pas shkarkimit të mallit.
3. Trotuaret dhe sheshet e vogla, mund të shfrytëzohen për shkarkimin e mallit dhe të materialit për ngrohje vetëm me lejen paraprake të organit kompetente komunal për rrugë.

#### **Neni 58**

##### **Afatet për shfrytëzim të hapësirave publike**

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë në harmoni me dispozitat e kësaj rregulloreje, janë të obliguar që t'i shfrytëzojnë trotuaret, shiritat e rrugëve dhe sipërfaqet tjera publike.
2. Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, shkaktohet dëmtimi i tyre, shfrytëzuesit janë të obliguar që të njëjtat t'i kthejnë në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e veta.
3. Vendosja e objekteve të përkohshme lëvizëse në hapësirat publike, mund të bëhet nga 01 maji deri më 30 shtator, me leje nga organi kompetent komunal.
4. Ndalohet hedhja e dheut, rërës, gurëve dhe materialit tjetër nëpër trotuare, sheshe të vogla, rrugë dhe sipërfaqe tjera të lira publike.

#### **Neni 59**

##### **Pëlqimi për punime**

1. Për ndërtimin e objekteve komunale, të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të rrjetit elektrik dhe telefonit e të ngjashme, mund të lejohet gropimi i shiritit të rrugëve dhe trotuareve.
2. Gropimi i trotuareve dhe shiritit të rrugëve nga paragrafi paraprakë, mund të bëhet me lejen e organit kompetent komunal.
3. Rregullorja me të cilën lejohet gropimi i trotuareve, shiritit të rrugës dhe të sipërfaqeve publike, përveç kushteve të tjera, përmban edhe obligimin e shfrytëzuesve, respektivisht të investitorit, që shiritin e rrugës dhe trotuarin ta kthejnë në gjendje të mëparshme.
4. Pjesa e rrëmihur e rrugëve dhe trotuareve rimbushet vetëm me zhavorr e jo, me dhe.

5. Organi kompetente komunal, para dhënies së lejes për gropimin e rrugëve shesheve të vogla dhe të sipërfaqeve tjera publike, do të kërkojë që investitori më parë ta paguajë taksën për gropim të paraparë me Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

#### **Neni 60** **Ndriçimi publik**

1. Të gjitha rrugët kryesore të qytetit, por edhe në fshatra dhe vendbanime të tjera, gjatë natës duhet të jenë të ndriçuara, nëse për këtë lejojnë kushtet teknike:

- 1.1. Vendet e llambave elektrike për ndriçim publik, duhet të jenë të vendosura ashtu që mundësojnë ndriçimin e tërësishëm të rrugëve, sipas normativave të përcaktuara.

#### **Neni 61** **Mirëmbajtja e ndriçimit publik**

Për ndriçimin e rrugëve, ndërrimin e llambave të djegura dhe mirëmbajtjen e rrjetit ndriçues në gjendje të rregullt, do të kujdeset ndërmarrja të cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së ndriçimit publik.

#### **Neni 62** **Punimet në rrjetin publik**

Kryerjen e punëve në rrjetin publik elektrik dhe telefonik do ta bëjë vetë ndërmarrja e autorizuar nga organi publik kompetent.

#### **Neni 63** **Veprimet e ndaluara**

1. Veprimet e ndaluara janë:
  - 1.1. thyerja, djegia ose në mënyrë tjetër dëmtimi i instalimit elektrik publik, instalimeve elektrike, shtyllave, kablllove, rrjetit të telefonit, mjeteve izoluese, trafo stacioneve etj.
  - 1.2. kryerja e punimeve në dhënien e lidhjeve për pajisjet shtëpiake, apo çfarëdo lidhje tjetër nga rrjeti i ndriçimit publik, shtyllave të instalimeve tjera, si dhe kontakti me to i personave të paautorizuar.

#### **Neni 64** **Firmat dhe reklammat**

1. Të gjitha subjektet që merren me biznes, janë të obliguara që të vendosin firmën në hapësirën punuese dhe atë ta vendosin në pjesën e jashtme të hyrjes kryesore të lokalit, në të cilën veprojnë dhe punojnë.
2. Vendosja e firmave, reklamave dhe të ngjashme nëpër muret e ndërtesave në hyrje të rrugëve, në qytet, në parqe dhe në vende të tjera publike, mund të bëhet vetëm me leje nga organi kompetent komunal.

**Neni 65**  
**Mbishkrimet e firmave ndriçuese**

Mbishkrimi i firmës duhet të jetë i shkruar dhe i lexueshëm. Mbishkrimet e firmave ndriçuese ose jo ndriçuese dhe reklamat, mund të vendosen vetëm në bazë të lejes së dhënë nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike.

**Neni 66**  
**Afatet e harmonizimit**

Mbishkrimet e firmave ndriçuese dhe reklamat, duhet të harmonizohen me dispozitat e kësaj rregulloreje në afat prej 6 muajsh pas miratimit të saj.

**Neni 67**  
**Mirëmbajtja e reklamave**

1. Pronarët e firmave me mbishkrime dhe reklama ndriçuese, janë të obliguar që t'i mbajnë ato në gjendje të rregullt.
2. Mbishkrimet e firmave ndriçuese duhet të jenë të ndezura gjatë natës, prej momentit të ndezjes deri në momentin e fikjes së dritave të ndriçimit publik.

**Neni 68**  
**Vendosja e mbishkrimeve në vend-punishte**

1. Në punishtet e objekteve në ndërtim e sipër të hapësirave punuese dhe në objektin i cili rinovohet ose adaptohet si punues, duhet të vendosen mbishkrimet e firmave ndriçuese sipas dokumentacionit teknik të lejuar.
2. Pronarët, gjegjësisht shfrytëzuesit e hapësirave punuese janë të detyruar që mbishkrimet e firmave ndriçuese t'i mbajnë në gjendje të rregullt.
3. Në rast transferimi ose ndalimi të punës, pronarët e hapësirave punuese janë të obliguar që mbishkrimet e firmës t'i largojnë.
4. Kontrollin inspektues e bënë organi kompetent komunal.

**Neni 69**  
**Kriteret e reklamave**

1. Tabelat, mbishkrimet e firmave, reklamat dhe të ngjashme mund të ndërtohen nga materiali që garanton sigurinë e ndriçimit.
2. Format dhe madhësia e tyre duhet të jenë në pajtim me standardin e objektit .
3. Ndalohet vënia e firmave varëse, jo stabile. Firmat ekzistuese varëse patjetër duhet të harmonizohen ose mënjanojnë në afat prej 60 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
4. Kontrollin inspektues e bënë organi kompetent komunal.

**Neni 70**  
**Kontrolli institucional**

1. Nëse organi i administratës komunale, kompetent për punët e inspektoratit, vërteton se mbishkrimi i firmës nuk është vendosur ose nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do të marrë vendim me të cilën do të obligohet subjekti afarist që mbishkrimin e firmës ta vendos në atë mënyrë si është e paraparë me rregullore.
2. Nëse shfrytëzuesi nuk vepron sipas Vendimit, vendosja e mbishkrimeve të firmave dhe largimin e mungesave të vërtetuara, do ta bëjë organi kompetent dhe shpenzimet për këtë do t'i bartë subjekti afarist.

**Neni 71**  
**Ndërtesat dhe pamja e jashtme e tyre**

Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit e ndërtesave, janë të obliguar që personalisht ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës, të ndërmarrin masa gjegjëse lidhur me pastrimin dhe mënjanimin e çfarëdo dëmtimi në linjën e ujësjellësi, kanalizimit dhe ndriçimit në hapësirat e përbashkëta në ndërtesë.

**Neni 72**  
**Eliminimi i prishjeve**

Nëse, në ndërtesë për shkak të prishjes së kanalizimit derdhen ujërat e zeza dhe ujërat fundrinore, në lokalet e përbashkëta e të ngjashme, shfrytëzuesit-pronarët e lokaleve apo ndërtesave janë të obliguar, që me shpenzimet e veta t'i eliminojnë prishjet në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit.

**Neni 73**  
**Mirëmbajtja e jashtme e objekteve**

1. Pamja e jashtme e ndërtesës (fasada, ballkoni, dyert, dritaret etj. pa marrë parasysh destinimin e tyre, shfrytëzimin apo pronësinë), patjetër duhet të mirëmbahen në pajtim me kërkesat estetike dhe pamjen e ndërtesës, ne përputhje me kushtet e përcaktuara nga organi kompetent komunal
2. Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit janë të obliguar që fasadat dhe detajet e fasadave (ballkonet, tarracat, ulluqet, tabelat dhe numrat e banesave e të ngjashme) të mirëmbahen, ngjyrosen dhe të përgatiten, ashtu që gjithmonë të jenë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen estetike.
3. Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit nga paragrafi 2 i këtij neni, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave në pajtim me rregullat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa ose ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

**Neni 74**  
**Kujdesi ndaj objekteve dhe hapësirave për rreth**

1. Oborret e ndërtesave dhe të lokaleve, duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.
2. Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit, nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave, në pajtim me rregullat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa, ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

**Neni 74**  
**Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve dhe hapësirave për rreth**

Pronarët e ndërtesave, respektivisht shfrytëzuesit e sipërfaqeve jo të ndërtuara, si dhe qiraxhinjtë e hapësirave afariste, janë të obliguar që t'i pastrojnë ndërtesat dhe sipërfaqet rreth ndërtesave, respektivisht të sipërfaqeve jo të ndërtuara të cilat i shfrytëzojnë ata.

**Neni 75**  
**Veprimet e ndaluara**

1. Ndalohet hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta: korridore, shkallë, ashensor e të ngjashme.
2. Ndalohet lëshimi i ujit dhe të ngjashme për larjen e ballkoneve me qëllim të pengimit të fqinjëve apo të tjerëve.
3. Ndalohet lirimi i tymit, çagjës, avullit, kundërmimit të rendë, gazrave toksike, etj, nga ndërtesat, lokalet punuese, tymtarët, gjeneratorët, etj, në afërsi të ndërtesave banesore dhe afariste shumëkatëshe, veçanërisht në afërsi të ballkoneve, fasadave, dritareve, tarracave dhe hyrjeve në korridore e në shkallë.
4. Ndalohet kryerja e punimeve pas orës 19 deri në 8 të mëngjesit, si dhe në ditët e vikendit dhe në ditë të festave.

**Neni 76**  
**Marrja e masave**

1. Organi kompetent komunal, me Vendim mund t'i urdhërojë personat përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rregullsisë së pjesëve të ndërtesave, që t'i eliminojnë mungesat dhe pengesat menjëherë apo në një afat të caktuar. (te caktohet afati)
2. Nëse obliguesi nuk vepron sipas Vendimit, ndaj tij do të merren masa sanksionuese sipas kësaj rregullore.

**Neni 77**  
**Rreziku i mundshëm**

1. Ndërtesat dhe objektet e tjera të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e vetë dhe japin një pamje jo të mirë, për arsye se janë vjetruar dhe mund të rrezikojnë ose paraqesin rrezik për

jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinjë, duhet të rrënohen ose të mënjanojnë.

2. Vendimin mbi rrënimin, respektivisht mënjanimin e merr organi kompetent komunal për punët e ndërtimit.
3. Nëse pronari, respektivisht organi kompetent komunal (përveç rasteve kur aktet ligjore ne fuqi e parashohin ndryshe) nuk e rrënon ndërtesën, respektivisht objektin tjetër në afatin e caktuar me vendim, rrënimin do ta bëjë organi kompetent komunal, ndërsa shpenzimet për këtë ia faturon obliguesit sipas vendimit.

## **Neni 78**

### **Vitrinat**

Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve të saponëduara afariste ose të ndërtesave banesore me hapësirat afariste, të cilat janë paraparë për shfrytëzim për nevojat vetjake ose për dhënie të tyre me qira, janë të obliguar që vitrinat, para fillimit të përdorimit, të bëhen ashtu siç parashihet me projektin e ndërtesës.

## **Neni 79**

### **Rregullimi i vitrinave**

1. Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste në qytet dhe në paratagjet e qytetit, janë të obliguar që vitrinat t'i rregullojnë në mënyrë estetike dhe profesionale.
2. Lëndët të cilat shërbejnë për ekspozim, duhet të jenë të pastra dhe të padëmtuara dhe çmimet e shkruara (te vendosen në vendet e dukshme) me material të njëjtë në të gjithë artikujt.
3. Nëpër vitrinat mund të vendosen reklamata e prodhimeve dhe shërbimet e shfrytëzuesve ose të ndërmarrjeve me të cilët shfrytëzuesi është në lidhje afariste.
4. Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste dhe pronarët e tyre janë të obliguar që të vendosin orarin e punës.
5. Mbishkrimi vendoset në derën hyrëse të hapësirës afariste, shitores-lokalit, në pjesën e brendshme.

## **Neni 80**

### **Mirëmbajtja e vitrinave**

1. Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të detyruar që vitrinat t'i mbajnë pastër dhe në gjendje të rregullt.
2. Në rast të zhvillimit të punëve në adaptimin, rikonstruktimin, regjistrimin e të ngjashme, vitrinat duhet të jenë të mbuluara nga shikimi i kalimtarëve dhe atë në mënyrën më të përshtatshme.

## **Neni 81**

### **Adaptimi i vitrinave të vjetruara**

1. Pronarët, respektivisht, shfrytëzuesit e ndërtesave afariste dhe të hapësirave afariste në qytet dhe në para lagjet e qytetit janë të obliguar që t'i adaptojnë vitrinat e vjetruara të cilat e shëmtojnë pamjen e ndërtesës.
2. Inspektorati komunal, vërteton vjetërsinë e vitrinës dhe përcakton mënyrën e adaptimit të hapësirës afariste nga paragrafi 1 i këtij neni paraprakë, respektivisht e obligon shfrytëzuesin e hapësirës në lidhje me adaptimin e vitrinës.
3. Lejen për adaptimin e vitrinës e lëshon organi kompetent komunal.
4. Vitrinat, skarat etj. të nxjerra jashtë murit të lokalit dhe në trotuar, të cilat i pengojnë kalimtarët, duhet të tërhiqen në afat prej 1 muaji, nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje. Pas kalimit të këtij afati, inspektori jep urdhër me shkrim për largim. Nëse prapë nuk bëhet largimi, atëherë nxjerr vendim për mbylljen e lokalit dhe, me shpenzime të pronarit, angazhon ndërmarrjen përkatëse për largimin e pengesës në trotuar - rrugë.

## **Neni 82**

### **Rrethojat**

Të gjitha rrethojat në sipërfaqe publike pa marrë parasysh pronësinë, mund të ndërtohen vetëm në bazë të pëlqimit për atë lokacion nga organi kompetent komunal.

## **Neni 83**

### **Mirëmbajtja dhe mënjanimi i rrethojave të vjetra**

1. Pronarët e rrethojave të vjetra, janë të detyruar që në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, t'i mënjanojnë ato dhe në vend të tyre të vendosin rrethojat e tipit të caktuar, sipas pëlqimit të organit kompetent.
2. Nëse ndërtimi i paraparë i rrethojës së tipizuar, kërkon mjete më të mëdha materiale nga organi kompetent komunal, mundet përkohësisht të lejojë që në vend të rrethojës së tipizuar të vihen rrethojat prej druri të gjelbër, por që ato të mirëmbahen deri në vendosjen e tipit gjegjës të rrethojës.
3. Të gjitha rrethojat duke i përfshirë edhe rrethojat e gjelbra, duhet të mirëmbahen në gjendjen e cila nuk e prishë pamjen e përgjithshme të asaj pjese të qytetit.
4. Rrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen ashtu që mos të kalojnë vijën e rregulluar dhe të mos pengojnë trafikun publik. Deri te momenti i formimit përfundimtar të rrethojës së gjelbër mund të shfrytëzohet si mbrojtëse rrethoja ekzistuese.

## **Neni 84**

### **Panot, tabelat e shpalljeve dhe ndalesat**

1. Të gjitha llojet e shpalljeve, lajmërimeve, pllakateve, monitorëve reklamues elektronik, dhe reklamave të tjera, përveç vitrinave të teatrove dhe të kinemave, mundet të vendosen vetëm në vendet e caktuara (panotë).

2. Organi kompetent komunal do të caktojë numrin të vendeve për panotë dhe tabelat e shpalljeve, me kërkesën e personave juridik - fizik.
3. Për mirëmbajtjen e panove dhe tabelave të shpalljeve do të kujdesen pronarët e tyre.
4. Për shpalljet më të vogla dhe lajmërimet për anëtarë të organizatave të ndryshme politike, kulturore dhe organizatave sportive, mund të vendosen vitrinat e vogla ose tabelat e shpalljeve në vendet e përshtatshme në afërsi të hapësirave vepruese ose afariste të atyre organizatave.
5. Vitrinat duke përfshirë edhe vitrinat e vogla nuk mund të vendosen nëpër fasada të hapësirave afariste, nëpër shtylla, ndërtesa banesore, si dhe vende tjera publike.
6. Ndalohet:
  - 6.1. publikimi i të gjitha llojeve të shpalljeve, pllakateve, e të ngjashme, si dhe vendosja nëpër drunjë dekorativ, rrethoja të objekteve, mure dhe fasada, shtylla elektrike, shtëpiza të transformatorëve, orman elektrik dhe pajisje të internetit, në shenjat e komunikacionit e të ngjashme.
  - 6.2. vendosja e panove dhe të reklamave nga ana e organizatave dhe të qytetarëve nevojitet , pa lejen e organeve kompetente komunale .
  - 6.3. vendosja e përkohshme e panove reklamuese dhe të tabelave të shpalljeve në vendet publike, nëse e njëjta krahas kërkesës nuk ka të bashkëngjitur edhe skica ose projekt me përshkrimet teknike, i cili përmban shënimet mbi madhësinë dhe vendet ku do të vendoset dhe mbi periudhën kohore të vendosjes.

## **Neni 85**

### **Gropat dhe pusetat në rrugë**

1. Për sigurinë e kalimtarëve dhe sigurinë e lëvizjes në trafik:
  - 1.1. të gjitha gropat dhe pusetat e të ngjashme në rrugë, sheshe, oborre, bodrume, korridore dhe në vendet e ngjashme duhet të jenë të mbyllura.
  - 1.2. pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, për kabllot elektrike dhe telefonike dhe të ngjashme gjithnjë duhet të ndërtohen dhe të mirëmbahen në gjendje të rregullt.
2. Për mirëmbajtjen e gropave, pusetave etj. nga paragrafi 1 pika 1.1 i këtij neni janë të obliguar që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme të cilëve u shërbejnë, ndërsa për gropat nga paragrafi 1 pika 1.2 e këtij neni, janë të detyruara të kujdesen ndërmarrjet të cilat e ushtrojnë atë veprimtari.

## **Neni 86**

### **Mirëmbajtja e gropave dhe pusetave**

1. Gropat dhe pusetat e të ngjashme të përfshira me këtë Rregullore, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të mbahen të mbyllura me mbulesë adekuate të sigurt.
2. Gjatë kohës së përdorimit, gropat duhet patjetër të rrethohen dhe të shënohen me shenjë që shihet mirë dhe sipas nevojës të mbyllen mirë që të mos e pengojnë sigurimin e kalimtarëve ose trafikut.

## **Neni 87**

### **Terrenet sportive**

Terrenet dhe fushat e sportit janë sipërfaqe publike të lira ku mbahen aktivitete sportive me qëllim të organizimit të garave dhe të argëtimit.

## **Neni 88**

### **Leja për terrenet sportive**

Terrenet sportive dhe objektet sportive, nuk mund të shfrytëzohen pa lejen paraprake të organit kompetent komunal.

## **Neni 89**

### **Ndalesat në terrenet sportive**

#### **1. Ndalohet:**

- 1.1. Kapërcimi i rrethojave të terreneve sportive dhe të qendrës sportive rekreative dhe hyrja në terren.
- 1.2. Hipja ose mbështetja në rrethojat e terreneve sportive dhe të qendrave sportive dhe rekreative.
- 1.3. Kullotja e bagëtisë në terrenet sportive dhe terrenet tjera sportive rekreative.
- 1.4. Të gjitha veprimet tjera me të cilat dëmtohen terrenet sportive dhe qendrat sportive e rekreative.

## **Neni 90**

### **Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e terreneve sportive**

1. Terrenet për sport dhe argëtim (stadiumi, qendra sportive-rekreative, fushat e sportit dhe hapësirat e objektet e ngjashme) duhet të mirëmbahen dhe pastrohen rregullisht, për të cilat kujdesen organet, personat juridik dhe individët të cilët këto objekte i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë.
2. Në hapësirat dhe objektet sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet që në vend të dukshëm të vendosen në formë të shkruar udhëzimet higjienike dhe teknike mbi punë në këto hapësira dhe terrene.
3. Vizitorët janë të obliguar që t'u përmbahen udhëzimeve dhe dispozitave nga paragrafi paraprak.

## **Neni 91**

### **Shënimi i rrugëve dhe i objekteve**

1. Të gjitha rrugët duhet të kenë të shënuar në këndet e tyre, tabelat me emërtimin e rrugëve ndërsa, ndërtesat dhe shtëpitë duhet të kenë numrat e tyre.
2. Shënimet me emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike, si dhe shënimet e ndërtesave, shtëpive dhe të trojeve bëhen nga ana e Drejtorisë përkatëse ose organi tjetër i autorizuar.
3. Shpenzimet sipas alinesë 1 dhe 2 të këtij neni bien në barrë të buxhetit të Komunës.

4. Për të gjitha çështjet tjera të cilat lidhen me emërtimet e rrugëve, shtëpive, ndërtesave dhe banesave zbatohen dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave.

### **Neni 92**

#### **Evidenca**

Drejtoria përkatëse, mbanë evidencën mbi rrugët, emërtimin e tyre dhe numrat e shtëpive dhe kryen ndërrimin me kohë të evidencave të nevojshme.

### **Neni 93**

#### **Kriteret**

Drejtoria përkatëse do të jap formën, madhësinë dhe ngjyrën e tabelave për shënimin dhe emërtimin e rrugëve dhe të shesheve, të tabelave me numër të shtëpive, do të caktojë mënyrën e shënimit dhe do të ketë evidencën në pajtim me nenin paraprak.

### **Neni 94**

#### **Objektet publike dhe higjienike**

Të gjitha ndërtesat, objektet hoteliere, (hotelet, motelet e të ngjashme) objektet për mbarëvajtjen e shfaqjeve, ligjëratave, hapësirat e klubeve, stacionet e autobusëve dhe objektet tjera të ngjashme, duhet patjetër të kenë më shumë nyje sanitare të ndërtuara në pajtim me dispozitat dhe kushtet higjienike-teknike.

### **Neni 95**

#### **Mirëmbajtja nyejve sanitare**

1. Nyejet sanitare në ndërtesat e kinemave, teatrove, lokaleve të klubeve, në objektet hoteliere, nëpër punëtori me prodhime jetësore-ushqimore, në terrenet sportive, nyejt sanitare publike në vendet tjera publike duhet të jenë të gëlqerosura në çdo 30 ditë, nëse nuk janë të ngjyrosura me ngjyra të yndyrshme ose nuk janë me pllaka qeramike ose prej materialit të ngjashëm.
2. Dezinfektimi i nyejve sanitare në objektet hoteliere, në kinema, spitale dhe nyje sanitare-publike, bëhet për çdo ditë, ndërsa në objektet tjera çdo 7 ditë.
3. Gjatë verës, nyejt sanitare sipas alinesë paraprake, çdo 7 ditë duhet të spërkaten me mjete dezinfektuese.

### **Neni 96**

#### **Kriteret për gropat septike**

1. Gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave dhe duhet të jenë të larguara nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe të ndërtesës fqinjë më së paku 2 m.
2. Gropat septike mund të ndërtohen nga çimentoja, guri ose tullat dhe duhet të jenë patjetër të lyera me mallter çimentoje dhe të izoluara.
3. Gropat pa tjetër duhet të jenë të mbyllura hermetikisht me pllakë betoni, guri ose metali.
4. Gropat septike nuk mund të ndërtohen në trotuare dhe në sipërfaqe tjera publike.
5. Lejen për ndërtim e jep Drejtoria për Urbanizëm në bazë të pëlqimit të inspektorit sanitar.

## **Neni 97**

### **Riparimi**

Drejtoria përkatës, mund të caktojë me vendim, mënjanimin e nyjës sanitare dhe të gropës septike dhe jep urdhër që të ndërtohet e reja, nëse ajo nuk është ndërtuar sipas kushteve të parapara të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe nëse paraqesin rrezik për rrethinën në pikëpamje shëndetësore dhe higjienike.

## **Neni 98**

### **Gropimi i sipërfaqeve publike**

1. Ndalohet çdo gropim dhe çdo dëmtim i sipërfaqeve publike, me përjashtim për rastet e parapara me këtë rregullore.
2. Qytetarët dhe personat civil-juridik, nuk mund të bëjnë gropim të sipërfaqeve publike.
3. Sipërfaqet mund të gropohen, në bazë të lejes së organit kompetent komunal, me rastin e vendosjes së rrjetit të ri të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit telefonik, elektrik të objekteve të sinjalizimit në trafik, pastaj lidhur me ndërlidhjen e ndërtesave dhe objekteve të tjera në rrjetë si dhe për mirëmbajtjen e instalimeve të këtyre objekteve (në tekstin e mëtejme pajisjet komunale).

## **Neni 99**

### **Leja e organit**

1. Sipërfaqet publike, me lejen e organit kompetent komunal, mund të bëjnë edhe mihjen për vendosjen e objekteve të përhershme ose të përkohshme, siç janë: shtyllat, panot, reklamat, ormanët për vendosjen e pajisjeve të internetit, telefonit, elektrikut, tabelat e shpalljeve e të ngjashme.
2. Objektet nga paragrafi paraprak, mund të mbesin edhe pas skadimit të afatit për të cilin janë vendosur, nëse shërbejnë për zbulimin e qytetit dhe nëse për to merret leja nga organi kompetent komunal.

## **Neni 100**

### **Meremetimi i sipërfaqeve të grupuara**

Sipërfaqet e grupuara publike duhet menjëherë të meremetohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme.

### **Neni 101**

#### **Evitimi i dëmeve**

1. Evitimi i prishjeve në pajisjet komunale dhe gropimi i sipërfaqeve publike, mund të bëhet nga ana e ndërmarrjeve të cilat kujdesen për këto pajisje dhe atë vetëm në raste kur kanë ngjarë prishjet dhe duhet urgjentisht të evitohen.
2. Në këtë rast, ndërmarrja e cila e ka bërë gropimin është e obliguar që menjëherë ose më së largu ditën e parë të punës ta njoftojë organin komunal kompetent për gropimin e sipërfaqes publike dhe njëkohësisht të kërkojë lejen për gropim.
3. Nëse organi kompetent vlerëson se evitimi i prishjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk ka qenë i natyrës urgjente, konsiderohet se punët e kryera janë bërë pa leje dhe kryesi i punëve i bartë të gjitha pasojat.

### **Neni 102**

#### **Gropimi i sipërfaqeve publike**

Gropimin e sipërfaqeve publike, në perimetër prej 1m për vënien e objekteve nga neni 105 i kësaj rregulloreje, mund ta bëjë edhe organizata e cila i vendos ato objekte, ndërsa meremetimin do ta kryejë vetë ose me anë të ndërmarrjes për mirëmbajtjen e objekteve komunale.

### **Neni 103**

#### **Kërkesa për leje**

1. Kërkesa për dhënien e lejes për gropimin e sipërfaqeve publike, duhet t'i përmbajë shënimet mbi llojin dhe sipërfaqen e bazës (shtresës) e cila duhet të rrëmihet, qëllimin e gropimit dhe vendin e saktë në të cilën do të bëhet gropimi, koha, fillimi dhe përfundimi i punëve etj.
2. Bashkë me kërkesën duhet të bashkëngjitet edhe situata (skica) e terrenit në shkallën 1:500 me terrenin e vizatuar dhe sipërfaqen për gropim, si dhe me pozitën e pajisjeve komunale në krahasim me pikat markante (të poshtme), si dhe thellësinë e gropimit.

### **Neni 104**

#### **Dhënia e lejes**

1. Lejen për gropimin e sipërfaqeve publike e jep organi kompetent për punë Komunale.
2. Organi nga paragrafi paraprak nuk mund ta japë lejen për gropim të sipërfaqeve publike në periudhën kohore prej 1 dhjetori deri më 28 shkurt.
3. Përgjashtimisht, në rastet e nevojave urgjente mund të lejohet gropimi në periudhën kohore prej 1 dhjetorit deri më 28 shkurt.
4. Në vendimin për lejimin e gropimit pa tjetër duhet të shënohet koha e fillimit të gropimit dhe e përfundimit të punëve në meremetimin e sipërfaqeve të grupuara.
5. Nëse punët për shkak të gropimit të sipërfaqes publike, nuk mund të kryhen në afatin e caktuar, investuesi është i obliguar që të kërkojë vazhdimin nga organi kompetent.

### **Neni 105**

#### **Sigurimi i vend-punimit**

1. Gjatë gropimit të sipërfaqeve publike vendi ndërtimor duhet patjetër të sigurohet në mënyrë të theksuar me shenja, rrethojë dhe masat tjera mbrojtëse në pajtim me dispozitat mbrojtëse në ndërtimtari.
2. Kryesi i punëve është i obliguar veçanërisht:
  - 2.1.që gropimin ta kryejë sipas lejes së dhënë;
  - 2.2.që vendi ndërtimor gjatë natës të jenë i ndriçuar;
  - 2.3.që vendin ndërtimor ta rregullojë ashtu që të mundësohet qarkullimi pa pengesë i automjeteve dhe i këmbësorëve,
  - 2.4. të shënohet vendi ku është lejuar, respektivisht ndaluar kalimi i automjeteve dhe këmbësorëve;
  - 2.5.punët të kryhen në pajtim me të gjitha kushtet teknike, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe të shesheve.
3. pas kryerjes së punëve, vendi në të cilin është punuar, duhet të kthehet në gjendje të rregullt paraprake dhe të largohen të gjitha materialet nga vendi ndërtimor.
4. rruga për trafik, në raste të veçanta mund të propozet në tërë gjatësinë e saj nëse nuk mund të kryhen punët në mënyrë tjetër dhe atë natën në kohë prej 22:00 deri në ora 4:00 të ditës së ardhshme.

### **Neni 106**

#### **Kthimi në gjendjen e mëparshme**

1. Baza e gropuar (sipërfaqja) duhet të kthehet në gjendje të mëparshme, sipas afatit i cili është caktuar me vendim të lejes për gropim.
2. Sipërfaqja e ndërtuar publike nuk guxon të shfrytëzohet pa lejen e organit kompetent.

### **Neni 107**

#### **Sigurimi i kalimit mbi pjesën e gropuar**

Nëse bëhet gropimi i trotuarit, kryesi i punëve është i obliguar që me mjete përkatëse të sigurojë kalimin mbi pjesën e groposur të rrugës.

### **Neni 108**

#### **Qasja në ndërtesa**

Kryesi i punëve është i obliguar që të sigurojë qasje pa pengesë në ndërtesat afariste dhe në lokale si dhe në ndërtesat banesore e objektet tjera.

**Neni 109**  
**Njoftimet për punime**

1. Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja ose rikonstruktimit të rrugëve ekzistuese, ndërmarrjet të cilat kujdesen për mirëmbajtjen dhe qeverisjen e pajisjeve komunale, si dhe qytetarët dhe organizatat të cilat në ato rrugë posedojnë objekte duhet të jenë të njoftuara së paku 1 muaj para fillimit të ndërtimit, rikonstruktimit që të përgatitet për vendosjen e pajisjeve komunale ose për lidhjen e objekteve të veta në këto pajisje.
2. Qytetarët dhe subjektet tjera me të cilat kanë të bëjnë dispozitat e alinesë paraprake, janë të obliguara që mbi nevojat e kryerjes së punëve në pajisjet komunale dhe në lidhjet që të njëjtit ta njoftojnë investitorin i cili punon ose ri-konstruktin rrugën, në mënyrë që vendosja e lidhjeve të bëhet para ndërtimit ose rikonstruktimit të rrugës.
3. Rrugët e projektuara dhe të ri-konstruktuar nuk mund të groposen para 3 vjetëve nga mbarimi i ndërtimit ose rikonstruktimit, përveç në raste të parapara me këtë rregullorë.

**Neni 110**  
**Zbatimi i rregullave**

1. Investuesi është i obliguar që para marrjes së lejes për rikonstruktimit të sipërfaqeve publike ta deponojë depozitën bankare në pajtim me rregullat e prokurimit) për evitimin e lëshimeve eventuale dhe meremetimin e sipërfaqeve publike.
2. Investuesi është i obliguar që para marrjes së lejes për rikonstruktimit të sipërfaqeve publike të sigurojë nga kryesi i punës garancinë për cilësinë e punëve të kryera.

**Neni 111**  
**Bartja e shpenzimeve**

1. Nëse në afatin garantues prej 1 viti nga dita e kryerjes së punimeve në sipërfaqet e grupuara paraqiten dëmtime, meremetimin e bartë investitori me shpenzimet e veta.
2. Nëse investitori nuk i kryen meremetimet në bazë të alinesë të theksuar më lartë, të njëjtat i kryen organi i administratës që ka lëshuar lejen.

**Neni 112**  
**Pastrimi i qytetit**

Në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurimit të kushteve higjienike në qytet dhe në para lagjet, rrugët, parqet, çerdhet e fëmijëve, oborret e ndërtesave familjare dhe afariste, trojet e lira dhe sipërfaqet tjera të hapura dhe të gjitha hapësirat e përbashkëta, duhet patjetër të mirëmbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

**Neni 113**  
**Kujdesi në mirëmbajtje**

Në mbajtjen e pastërtisë janë të detyruar të kujdesen qytetarët, ndërmarrjet, institucionet dhe , organizatat tjera.

**Neni 114**  
**Përfshirja e objekteve në mirëmbajtje**

1. Lidhur me mbajtjen e pastërtisë në kuptim të dispozitave të kësaj rregulloreje, përfshihen këto objekte:

- 1.1. rrugët, trotualet dhe sheshet;
- 1.2. parqet;
- 1.3. shëtitoret, terrenet sportive dhe argëtuese;
- 1.4. stacionet e autobusëve dhe vendqëndrimet e autobusëve në vijat urbane dhe ndër-urbane;
- 1.5. ambulancat, spitalet dhe çerdhet e fëmijëve;
- 1.6. stacionet e karburantit;
- 1.7. varrezat, tregjet, shtrati i lumit dhe
- 1.8. hapësirat e hapura dhe të zbrazëta ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe toka ndërtimore e pa ndërtuar (trojet e zbrazëta).

**Neni 115**  
**Mirëmbajtja e pastërtisë**

1. Për mbajtjen e pastërtisë në stacionet e autobusëve, të karburanteve si dhe objektet hoteliere, auto kampet dhe në vendet e ngjashme, janë përgjegjëse ndërmarrjet subjektet të cilat e kanë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve.
2. Shfrytëzuesit nga paragrafi 1 i kësaj rregulloreje janë të obliguar që në peronet, sallat e pritjes dhe në vendet tjera ku frekuentojnë njerëzit, në vendet e përshtatshme, të vendosin numër të mjaftueshëm të shportave për hedhjen e mbeturinave.
3. Nyejt sanitarë publik, duhet mbajtur në gjendje të rregullt dhe të pajisura me mjete të nevojshme si dhe të dezinfektohen kohë pas kohe me mjete përkatëse.
4. Nyejt sanitarë publik pa tjetër duhet të jenë të hapura çdo ditë prej orës 5:00 deri në ora 24:00.

- Neni 116**
1. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike janë të obliguar që të kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre sipërfaqeve.
  2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, punët mund t'i besojnë ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e pastërtisë në pajtim me procedurat e prokurimit.

**Neni 117**  
**Dëshmitë mbi taksën e paguar**

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike janë të obliguar që ato t'i mbajnë në gjendje të pastër.
2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore, të hapësirave afariste dhe trojeve të zbrazëta, janë të detyruar që t'i pastrojnë trotualet dhe sipërfaqet e tyre rreth ndërtesave para trojeve.
3. Organi i administratës kompetent për punë komunale para dhënies së lejes për shfrytëzimin e sipërfaqeve të lira publike nga subjekte të ndryshme do të sigurojë më parë dëshminë mbi taksën e paguar dhe obligimet tjera që kërkojnë sipas ligjit e akteve nënligjore në fuqi.

**Neni 118**  
**Mirëmbajtja e ndërtesave**

Të gjitha oborret dhe korridoret e ndërtesave banesore duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër. Për mirëmbajtjen e oborreve dhe korridoreve të ndërtesave banesore, kujdesen pronarët respektivisht shfrytëzuesit e atyre oborreve, korridoreve dhe bodrumeve.

**Neni 119**  
**Mirëmbajtja e xhamave të vitrinave**

Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që ato t'i mbajnë të pastra. Xhamat nëpër dritare dhe vitrina duhet të jenë gjithmonë të pastër dhe në gjendje të rregullt.

**Neni 120**  
**Mirëmbajtja e ambientit të fshatit**

1. Të gjithë banorët në vendet e banuara me karakter fshati apo vendbanimi, janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në vendet publike dhe sipërfaqet tjera.
2. Qytetarët e vendbanimeve të karakterit të fshatit janë të obliguar t'i pastrojnë trotuarët respektivisht pjesët e rrugëve para shtëpive të veta, oborret dhe sipërfaqet tjera përpara dhe rreth shtëpisë.
3. Ndalohet:
  - 3.1.hedhja e mbeturinave dhe materialit tjetër fundrrinor në shtratin e lumenjve, liqeve , përrenjve, në rrugë dhe në sipërfaqe tjera publike dhe kudo tjetër jashtë deponisë së qytetit;
  - 3.2.hedhja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve të tyre;
  - 3.3.kanalet përcjellëse të ujit fundrrinor dhe të fekaleve të mos kalojnë nëpër rrugë, në sipërfaqe të lira publike dhe në oborret e huaja;
  - 3.4.të mbyllen lëshesat, kanalet përcjellëse nëpër rrugët e rendit të IV dhe dëmtimet e ndryshme të këtyre pajisjeve.

**Neni 121**  
**Pastrimi i rrugëve**

1. Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës dhe në kohën e cila e siguron efektin më të mirë të pastrimit dhe që në masën më të vogël pengon qarkullimin e kalimtarëve dhe zhvillimin normal të trafikut.
2. Ndalohet pastrimi i rrugëve në kohën prej orës 7:00 deri në ora 23:00, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

**Neni 122**  
**Orari për pastrimin e rrugëve**

Larja e rrugëve mund të bëhet prej orës 24:00 deri në ora 5:00 të ditës vijuese.

**Neni 123**  
**Pastrimi i rrotave nga balta**

1. Të gjitha automjetet tjera tërheqëse, para hyrjes në sipërfaqet publike të trafikut publik duhet patjetër të pastrohen nga balta dhe mbeturinat tjera.
2. Nga balta dhe papastërtia, patjetër duhet pastrohen edhe të gjitha mjetet bartëse para daljes në sipërfaqe publike, në trafikun publik nga shkarkimet, nga objektet ndërtimore dhe nga hapësirat tjera nga të cilat balta dhe papastërtitë tjera mund të bartën në sipërfaqe publike.

**Neni 124**  
**Qëndrimi i mjeteve për pastrim**

1. Mjetet (qerret) tërheqëse mund të qëndrojnë, vetëm në vendin e caktuar për ato qëllime nga ndërmarrja publike që kujdeset për pastërtinë e qytetit në bashkëpunim me organet komunale.
2. Për mbajtjen e pastërtisë, në vendet sipas alinesë paraprake pronarët e mjeteve tërheqëse ia paguajnë kompensimin ndërmarrjes e cila kujdeset për mbajtjen e pastërtisë në këto vende. Ndalja dhe parkimi në trotuar, sheshet e vogla dhe rrugë të qerreve tërheqëse ndalohet rreptësisht.

**Neni 125**  
**Vendosja e shportave dhe kontejnerëve**

1. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendosen shportat për mbeturina dhe kontejnerët për mbeturina, në numër të mjaftueshëm dhe ato i sigurojnë shfrytëzuesit.
2. Për vendosjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shportave dhe kontejnerëve, kujdeset ndërmarrja për mirëmbajtjen e higjienës publike.
3. Mënyrën vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe tjera publike, e cakton organi përkatës nga Drejtoria përkatëse, në bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

**Neni 126**  
**Bartja e mbeturinave**

1. Bartja e mbeturinave bëhet ditën dhe natën. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten duhet patjetër të jenë të mbyllura ose të mbuluara, ashtu që të pengohet derdhja e tyre gjatë transportit në deponinë e caktuar.
2. Orarin për bartjen e mbeturinave e cakton Drejtoria përkatëse.

**Neni 127**  
**Mjetet speciale për bartje**

1. Mbledhja e mbeturinave nga hapësirat banesore e afariste bëhet me anë të enëve speciale.
2. Vendi dhe mënyra e vendosjes së enëve speciale caktohet nga ana e Drejtorisë përkatëse, në bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

**Neni 128**  
**Numri përkatës i mjeteve për pastrim**

1. Ndërmarrja dhe qytetarët janë të obliguar që me shpenzimet e veta të sigurojnë dhe të kenë numër përkatës të mjeteve, enëve speciale për mbledhjen e mbeturinave nga hapësira e tyre punuese dhe sipërfaqet e lira.
2. Sigurimin e enëve-mjeteve speciale nga kjo rregullore, janë të detyruar që ta bëjnë në afat prej 1 muaji nga dita e hyrjes në fuqi të saj.

**Neni 129**  
**Transportimi në deponinë e autorizuar**

1. Mbeturinat dhe fundërrinat do të transportohen në deponinë e autorizuar.
2. Vendi i mbeturinave duhet t'i plotësojë standardet sipas ligjit.

**Neni 130**  
**Ndërmarrja e autorizuar**

1. Bartjen e mbeturinave nga enët e caktuara për mbeturina (enët speciale dhe kontejnerët) e kryen ndërmarrja së cilës i besohen punët.
2. Ndërmarrjes kontraktuese së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e higjienës së qytetit, është e obliguar që t'i përmbahet plan programit të miratuar për pastrimin e qytetit sipas kontratës së punës.
3. Për çdo ndryshim në lidhje me planin dhe programin e pastrimit, ndërmarrja është e obliguar që t'i lajmërojë me kohë, në lidhje me ndryshimet, organet gjegjëse mbikëqyrëse.
4. Tarifën për lartësinë e kompensimit e cakton komuna.

**Neni 131**  
**Nyejt sanitare higjienike**

1. Ndërtesat duhet të kenë nyejt sanitare higjienik. Nëse nuk kanë, pronarët e ndërtesës dhe të lokaleve afariste janë të obliguar që në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje t'i ndërtojnë nyejt sanitarë përkatëse higjienike.
2. Ndërtimi i nyejve sanitare higjienike dhe të gropave septike do të bëhet vetëm nëpër vende të përshtatshme. Vendet në të cilat do të ndërtohen duhet të caktohen nga ana e inspektorit dhe organit kompetent për punë komunale.

**Neni 132**  
**Pastrimi i gropave septike**

Heqja e fekaleve nga gropat septike, nyejt sanitarë dhe të ngjashme bëhet me anë të cisternave septike sipas rregullit gjatë natës prej orës 21:00 deri në ora 5:00 të mëngjesit.

**Neni 133**  
**Detyrat e kryesve të punëve ndërtimore**

1. Kryesit e punëve ndërtimore janë të obliguar që të kujdesen për:

- 1.1. pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore deri te vendi i shkarkimit të materialit;
- 1.2. derdhjen e materialit shkapërderdhës dhe gjatë rrënimit të pengohet pluhuri;
- 1.3. deponimi dhe sigurimin e materialit ndërtimor nga rrënimi dhe bartjen e tij nga sipërfaqja publike.

**Neni 134**  
**Rregullimi i hapësirave pas përdorimit**

Personat fizik dhe ata juridik të cilët bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose të materialit para ndërtesave në rrugë ose trotuare janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë ato dhe ta pastrojnë vendin.

**Neni 135**  
**Pastrimi i borës**

1. Për pastrimin e borës nga trotuaret dhe para ndërtesave afariste dhe banesore në pronësi publike, kujdesen personat juridik të cilat i shfrytëzojnë ndërtesat afariste dhe këshillat shtëpiake, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave familjare banesore dhe para hapësirave afariste (punëtoritë, lokalet afariste) kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore dhe të hapësirave afariste.
2. Ndërmarrjet dhe qytetarët janë të obliguar që gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga paragrafi 1 të këtij neni ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit, ndërsa ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë është e obliguar që borën e grumbulluar në skaje të trotuarit ta bart menjëherë jashtë qytetit e më së voni brenda 10 orësh.
3. Ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike është e obliguar që nga rrugët, trotuaret, trafikut publik dhe atij të dorës së dytë të kujdeset dhe rregullisht t'i pastrojnë ato nga bora dhe akulli si dhe të hedhin kripë mbi to.
4. Ndalohet hedhja e borës dhe akullit në rrugë nga ana qytetarëve dhe ndërmarrjet.

**Neni 136**  
**Pastrimi i bores nga qytetaret**

Në rastet kur gjatë ditës bie borë, trotualet sipas nevojës do të pastrohen edhe disa herë në ditë duke u angazhuar detyrimisht të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet, në rast se bora bie pandërprerë gjatë natës, e njëjta do të pastrohet në ditën e ardhshme e më së voni deri në ora 9:00 të mëngjesit.

**Neni 137**  
**Mbajtja e pastërtisë dhe higjienës komunale në tregje dhe në objektet e tregjeve**

Për mbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës komunale nëpër tregje dhe objekte të tregjeve do të kujdeset pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tregjeve.

**Neni 138**  
**Mirëmbajtja e tregjeve**

Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Çdo ditë tregjet pas kalimit të kohës së punës duhet të pastrohen mirë, lahen dhe të jenë në gjendje të rregullt.

**Neni 139**  
**Sigurimi i ujit në tregje**

Ndërmarrja e cila menaxhon me tregjet, është e obliguar që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit të rregullt higjenik të pijshëm për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve, si dhe të ndërtojë numrin e caktuar dhe të nevojshëm të kabinave të njejtve sanitare, të cilat duhet rregullisht të pastrohen dhe të mirëmbahen dhe të vihet numri i mjaftueshëm i enëve, kontejnerëve për mbeturina dhe fundërrina, të cilat duhet të pastrohen rregullisht.

**Neni 140**  
**Ndaletat**

1. Ndalohet:

- 1.1. Pastrimi i tregut dhe i vendeve për shitje gjatë kohës së zgjatjes së afarizmit në treg.
- 1.2. Çdo shitje e mallit dhe e gjërave tjera ushqimore jashtë vendit të caktuar për këtë dhe ekspozimi i tyre para lokaleve afariste.
- 1.3. Shitja dhe ekspozimi i mallrave në vendet dhe hapësirat në afërsinë e tregut, e që do të pengonte qasjen dhe qarkullimin e lirë të blerësve, në hapësirat para tregut dhe në hyrje të drejtpërdrejtë të tregut, të cilat në çdo kohë duhet të jenë të lira për kalimtar blerës dhe trafikun e automjeteve dhe të mjeteve tjera.

**Neni 141**  
**Sigurimi i kushteve higjienike**

Në hapësirat e tregut ku bëhet shitja e kafshëve, duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e ujit higjenik për pije dhe ujit për kafshë, si dhe të ndërtohen nyje sanitare me numër të caktuar të kabinave, të ndërtohen vendet për lidhjen e kafshëve dhe vendosen enët për grumbullimin e

mbeturinave dhe të fundërrinave, ndërsa hapësira e tregut pas çdo dite të tregut duhet të pastrohet mirë nga plehu dhe nga fundërrinat tjera.

## **Neni 142** **Shitja e materialit për ngrohje**

1. Hapësira e tregut për shitjen e materialit për ngrohje (dru, thëngjill ), si dhe asortimenteve tjera nga druri, për shitjen e gëlqeres dhe të prodhimeve të ngjashme duhet të mbahet në rregull, në gjendje të pastër dhe pas çdo dite të tregut pas kohës së punës të pastrohet.
2. Ndalohet shitja e prodhimeve të theksuara-materialit jashtë hapësirës së tregut të caktuar për këto destinime.

## **Neni 143** **Ndalesat**

### **1. Në sipërfaqe publike ndalohet:**

1. hedhja e mbeturinave jashtë shportave për mbeturina dhe enëve për mbeturina, ose në mënyra tjera të krijohet papastërtia në sipërfaqe publike;
2. prerja dhe copëtimi i drunjëve, të grimcohet thëngjilli dhe materiali tjetër me përjashtim në parcelat e zbrazëta, nëse për këtë ekziston leja për ndërtim të ndërtesave banesore dhe të tjera;
3. larja e të gjitha mjeteve motorike, rrobave dhe lëndëve të tjera;
4. meremetimi i automjeteve dhe kryerja e veprimtarive zejtare;
5. lëvizja e automjeteve në të cilat është grumbulluar balta dhe papastërtia tjetër;
6. lëvizja e automjeteve të cilat nuk janë siguruar nga materiali derdhës, i cili transportohet ose automjeteve të cilat mundësojnë përhapjen e gazrave gjatë transportimit (fekalet) dhe materialit tjetër me erë jo të këndshme, përveç lëndës së asfaltit;
7. lëshuarja dhe shpërndarja e ujit fundrrinor dhe të ndyrësirave tjera në sipërfaqe publike, në oborret fqinje dhe në korridoret e përbashkëta ose në ato sipërfaqe të hedhen si dhe të mbahen mbeturinat e të ngjashme;
8. lëvizja e kafshëve dhe e shpezëve;
9. kryerja e nevojës fiziologjike;
10. hapja e enëve me mbeturina (të enëve dhe të kontejnerëve);
11. prishja dhe marrja e lëndëve fundrrinore nga kanta dhe kontejnerët;
12. ndezja e mbeturinave nëpër enë dhe në sipërfaqe publike;
13. hedhja në enët për mbeturina, si vijon: dheut, rërës, ambalazhit, mbeturinave nga kopshtet dhe mbeturinat e ngjashme;
14. zhvendosja e dyerve dhe mbulesave (kapakëve) nëpër enët për mbeturina;
15. zhvendosja e enëve për mbeturina nga vendet e caktuara, pa lejen e organit për punët komunale;
16. përdorimi i enëve për mbeturinat me vëllim mbi 120 l;
17. hedhja e mbeturinave dhe të fundërrinave të tjera jashtë enëve për mbeturina;
18. hedhja e thëngjillit jo të djegur, të hirit dhe të materialit tjetër ndezës nëpër enët për mbeturina (kontejner);
19. lëshimi i ujit nga krojet nëpër oborre, nëpër rrugë dhe nëpër oborret e huaja;

20. mbajtja e hidrantëve për ujë nëpër rrugë në gjendje jo të rregullt;
21. ndalimi i automjetit ose qerreve tërheqëse pranë enëve për mbeturina kontejnerëve, trotuareve, shesheve të vogla, sipërfaqeve të gjelbëruara, etj;
22. parkimi i të gjitha mjeteve motorike dhe të mjeteve tërheqëse nëpër trotuare;
23. vendosja e tavolinave, karrigeve, tezgave lëvizëse, ambalazhit, mallrave, bankomatëve, frigoriferëve, gjeneratorëve, ormanëve për internet, të objekteve reklamuese e të ngjashme;
24. mbajtja e papastërtisë në hapësirën ku bëhet pastrimi i veshmbathjes;
25. të mbahen mbeturinat dhe fundërrinat nëpër enët të cilat nuk i plotësojnë kushtet për to;
26. në sipërfaqe publike, rrugë dhe trotuare të bëhet shtrirja e armaturës dhe lidhja për shtylla dhe rendin e drunjëve për t'i drejtuar ato;
27. dalja nga vendi ndërtimor dhe nga sipërfaqet tjera të ngjashme me automjetet të ndotura në sipërfaqe publike të trafikut publik,

#### **Neni 144** **Ndalesat**

Në territorin e qytetit dhe në para lagjet ndalohet:

- 1.1. nxjerrja e materialit ndërtimor, eksploatimi i fraksioneve të gurit nga prerjet e tullave skaj rrugëve publike e të ngjashme;
- 1.2. lëshimi ose përcjellja e ujit fekal nga gropat e nyejve sanitare, si dhe mbeturinat e gropave septike nëpër kopshte, kanale, lumenj, në rrugë dhe në oborre fqinje;
- 1.3. të hedhen dhe të derdhen nëpër oborre ose para hapësirave të ndërtesave banesore mbeturinat, fekalet, uji si dhe në çfarëdo mënyre të dëmtohen kushtet higjienike të qytetarëve të tjerë ose të banuesve;
- 1.4. t'u jepet ujë kafshëve nëpër krojet publike;
- 1.5. të hedhen dhe të mbulohen kafshët dhe shpezët e ngordhura jashtë varrezave të destinuara për kafshë;
- 1.6. të largohen dhe të lidhen mjetet tërheqëse në vendet në të cilat nuk janë caktuar për këto qëllime;
- 1.7. të bëhet prodhimi me dorë i tjegullave dhe tullave si dhe i gëlqeres.

#### **Neni 145**

1. Në gjithë territorin e Komunës rreptësisht ndalohet:

1. djegia e hamullorëve (kashtës dhe mbetjeve të drithërave), gomave, vajrave motorike, plastikës, pesticideve, barnave dhe të gjitha mbeturinave tjera toksike;
2. hedhja në sipërfaqe të tokës, ujit dhe kanalizimeve e vajrave motorike, pesticideve, barnave dhe substancave tjera toksike.

#### **Neni 146** **Kontraktimi i punëve**

Për shërbimet të cilat ndërmarrjes i besohen punët për pastrimin e rrugëve të shtruara largimit të borës dhe të akullit, transportimin dhe deponimin e tyre në sipërfaqet në pajtim me këtë rregullore, i takon kompensimi në lartësinë dhe në kushtet të cilat përcaktohen me kontratë dhe me tarifën e lejuar.

### **Neni 147**

#### **Inspektimi**

1. Inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë ka të drejtë që ta ndalë automjetin i cili transporton mallra, material ndërtimor, material fundrrinorë, drunjë, thëngjill etj.
2. Ndalimin e automjeteve në fjalë inspektori e bënë me paraqitjen e shenjës për komunikacion ”Ndalohet trafiku në të dy drejtimet”, në të cilin është shkruar “STOP INSPEKTORATI”, vozitësit e automjeteve janë të obliguar që t’i ndalin automjetet në këtë shenjë dhe duhet t’i ofrojnë shënimet që kërkohen nga inspektorët.
3. Ndalimi i automjeteve nga paragrafi 2 e këtij neni nuk guxon të kryhet nëpër vende ku do të bëhet rrezikimi i sigurisë në trafik.

### **Neni 148**

#### **Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e kryejnë organet komunale të administratës si: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje te Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektorati.

### **Neni 149**

#### **Sanksionet kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **20€ deri 1,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik.
2. Dënohet me gjobë në shumën prej **50€ deri 3,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
3. Dënohet me gjobë në shumën prej **150€ deri 10,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1 Nëse nuk e kryejnë pastrimin e të gjithë mbledhësve të ujit dhe të pusetave për ujin atmosferik më së paku dy herë në vit (neni 5 paragrafi 5),
  - 4.2 Nëse nuk ua sigurojnë konsumuesve sasinë e mjaftueshme të ujit higjienik dhe të rregullt (neni 8),
  - 4.3 Nëse nuk e pengon çdo derdhje të tepër të ujit (neni 30),
  - 4.4 Nëse nuk e kryen pastrimin e rregullt të mbledhësve të ujit dhe të pusetave për kanalizimin atmosferik dhe atë fekal, në mënyrë që çdo kohë të mund të përgjigjet destinimit të vet (neni 33),
  - 4.5 Pas kryerjes së punëve të ujësjellësit dhe të kanalizimit të cilat ajo i kryen dhe nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt (neni 34 paragrafi 1),
  - 4.6 Nëse nga rrugët, trotualet dhe sipërfaqet publike nuk e largon materialin e tepërt në afatin e paraparë me vendimin nga ana e organit kompetent (neni 35),
  - 4.7 Nëse i shfrytëzojnë sipërfaqet e gjelbra jashtë suazave të tyre pa lejen e organit kompetent (neni 46),

- 4.8 Nëse nuk i eviton dëmet në rrugët e trafikut, trotuaret si dhe nëse tereni nuk e bie në gjendjen e mëparshme të rregullt (neni 56),
- 4.9 Nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vjen deri te dëmtimi i tyre (neni 61),
- 4.10 Nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar të paraparë (nenin 69),
- 4.11 Nëse nuk vepron në pajtim me nenin 71,
- 4.12 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 78 dhe 79,
- 4.13 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara me nenin 81,
- 4.14 Nëse nuk e kryen aranzhimin profesional të artikujve nëpër vitrina, nuk i shkruan çmimet e artikujve me material të njëjtë, nuk e shpallë me shkrim orarin e punës fillimin dhe mbarimin e punës (neni 84),
- 4.15 Nëse vërtetohet dhe vlerësohet nga ana e organit kompetent se lëshimi i lejes për rrëmihje dhe evitimin e prishjeve nga neni 110 paragrafi 1 nuk ka qenë i natyrës urgjente (neni 110.3),
- 4.16 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 112,
- 4.17 Nëse me rastin, kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141, paragrafi 1,2,3 dhe 4.
5. Për kundërvajtje nga neni 5 deri 22 dhe neni 30, 33, 34, 35, 46, 56, 61, 69, 71, 81, 87, 110, 112, 141, dhe 151 të kësaj rregulloreje do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej 50€ edhe personi përgjegjës i personit nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tij.

### **Neni 150** **Sanksionet kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **20€ deri 1,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik.
2. Dënohet me gjobë në shumën prej **50€ deri 3,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
3. Dënohet me gjobë në shumën prej **150€ deri 10,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  1. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 11 dhe 12;
  2. për shkak të lidhjes me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa leje (neni 17);
  3. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 22 dhe 36;
  4. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 47, 48, 49, 50, 52, 53, 57, 60;
  5. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 70,72,73,75,76;
  6. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 80 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 82;
  7. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 66 paragrafi 1 dhe 2;
  8. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 86,88 dhe 90;
  9. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94, 95 paragrafi 1,2,3 dhe 4;
  10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 96;
  11. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 119;
  12. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 111,112,113,114,117;
  13. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara nga neni 123;
  14. nëse nuk sillet në pajtim me nenin 124 dhe 125;

15. nëse nuk e bënë shpëlarjen e rrugëve dhe pastrimin në pajtim me kontratën në mes të organeve përkatëse të administratës komunale dhe ndërmarrjes punuese kompetente (neni 130,131);
- 4.1.nëse nuk e siguron numrin e mjaftueshëm të enëve speciale dhe kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha hapësirat punuese dhe sipërfaqet e lira (neni 134);
- 4.2.nëse vepron në kundërshtim me nenin 136 dhe 137;
- 4.3.nëse nuk e bënë pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore, nëse nuk e spërkatë materialin e grimcuar gjatë rrënimit në mënyrë që mos të ngjitet pluhuri (neni 139);
- 4.4.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 139;
- 4.5.nëse nuk i përmbahet masave të përcaktuara nga neni 140;
- 4.6.nëse kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 dhe 142;
- 4.7.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 143,144,145, 146, 147, 148 dhe149;
- 4.8.nëse nuk i respekton nenet 150 dhe 151;
- 4.9.nëse gjatë qitjes së shenjës së komunikacionit “STOP-INSPEKTORATI” vozitësit e automjeteve të rënda nuk i ndalin dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara inspektorit (neni 153).
5. Për kundërvajtje nga neni 156 të nën-paragrafëve 1.11,1.12,1.13,1.14,1.15,1.16,1.17,1.19,1.20, 1.21,1.22,1.23 dhe 1.24 do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej 50€ edhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tyre.

### **Neni 151**

#### **Sanksionet kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **20€ deri 1,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik.
2. Dënohet me gjobë në shumën prej **50€ deri 3,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
3. Dënohet me gjobë në shumën prej **150€ deri 10,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1.nëse pa lejen përkatëse bënë kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (neni 17),
  - 4.2.nëse bënë ndonjërrën prej veprimeve të ndaluara nga neni 36 paragrafi 1,2,3,4,5,6,7, 8,9 dhe 10,
  - 4.3.nëse bënë ndonjërrën prej veprimeve nga neni 53 paragrafi 1 deri 18,
  - 4.4.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 61,
  - 4.5.nëse vepron në kundërshtim me nenin 62 paragrafi 3, 4 dhe 5,
  - 4.6.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 70 deri 77,
  - 4.7.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 78, 79, dhe 80,
  - 4.8.nëse nuk vepron sipas vendimit të drejtorisë së inspektoratit, respektivisht nëse nuk i eviton mungesat në afatin e caktuar (neni 81),
  - 4.9.nëse nuk e eviton rrezikun nga rrënimi i objekteve i cili është rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të objekteve fqinjë dhe sigurinë në trafik (neni 82),

- 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e (neneve 86, 87, 88 dhe 89)
- 4.11. nëse bënë ndonjërin prej veprimtarive të ndaluara nga neni 95
- 4.12. nëse nuk e bënë dezinfektimin e njeve sanitare dhe gëlqerosjen e tyre të paraparë me nenin 101;
- 4.13. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 104;
- 4.14. nëse nuk u përmbahet masave të caktuara nga nenet 111, 112, 113, 114 dhe 117
- 4.15. nëse bënë ndonjërin prej veprimeve me të cilin nuk respektohet neni 126,
- 4.16. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 141,
- 4.17. nëse nuk respektohet neni 146,
- 4.18. nëse bënë ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 149 nga pika 1 deri në pikën 26.
- 4.19. nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal në “STOP-INSPEKTORI” vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara nga inspektori (neni 153).

### Neni 152 Sanksionet kundërvajtëse

- 1. Dënohet me gjobë në shumën prej **20€ deri 1,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik.
- 2. Dënohet me gjobë në shumën prej **50€ deri 3,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
- 3. Dënohet me gjobë në shumën prej **150€ deri 10,000€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
- 4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 35, nëse i shfrytëzon sipërfaqet publike të gjelbra jashtë destinimeve të tyre themelore pa leje nga organi kompetent (neni 46),
  - 4.2.nëse bënë ndonjërin nga veprimet e ndaluara nga neni 57 paragrafi 1 dhe 2,
  - 4.3.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 60,
  - 4.4.nëse bënë ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 70 paragrafi 1 dhe 2
  - 4.5.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 78,
  - 4.6.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 81 dhe 82,
  - 4.7.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94 dhe neni 95,
  - 4.8.nëse nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt në sipërfaqen e rrëmihur të paraparë sipas nenit 111,
  - 4.9.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 122,123 dhe 126,
  - 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 129,130 dhe 134,
  - 4.11. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 140,
  - 4.12. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 146,
  - 4.13. nëse bënë ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 150 pika 1 deri në 7,

**Neni 153**  
**Sanksionet e lehta kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **10€ deri 100€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik,
2. Dënohen me gjobe në shumën prej **30€ deri 250€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual,
3. Dënohen me gjobë në shumën prej **100€ deri 1.500€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1.Nëse nuk e kryejnë pastrimin e të gjithë mbledhësve të ujit dhe të pusetave për ujin atmosferik më së paku dy herë në vit (neni 5 paragrafi 5),
  - 4.2.Nëse nuk ua sigurojnë konsumuesve sasinë e mjaftueshme të ujit higjienik dhe të rregullt (neni 8),
  - 4.3.Nëse nuk e pengon çdo derdhje të tepër të ujit (neni 30),
  - 4.4.Nëse nuk e kryen pastrimin e rregullt të mbledhësve të ujit dhe të pusetave për kanalizimin atmosferik dhe atë fekal, në mënyrë që çdo kohë të mund të përgjigjet destinimit të vet (neni 33),
  - 4.5.Pas kryerjes së punëve të ujësjellësit dhe të kanalizimit të cilat ajo i kryen dhe nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt (neni 34 paragrafi 1),
  - 4.6.Nëse nga rrugët, trotualet dhe sipërfaqet publike nuk e largon materialin e tepërt në afatin e paraparë me vendimin nga ana e organit kompetent (neni 35),
  - 4.7.Nëse i shfrytëzojnë sipërfaqet e gjelbra jashtë suazave të tyre pa lejen e organit kompetent (neni 46),
  - 4.8.Nëse nuk i eviton dëmet në rrugët e trafikut, trotualet si dhe nëse tereni nuk e bie në gjendjen e mëparshme të rregullt (neni 56),
  - 4.9.Nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vjen deri te dëmtimi i tyre (neni 61),
  - 4.10.Nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar të paraparë (nenin 69),
  - 4.11.Nëse nuk vepron në pajtim me nenin 71,
  - 4.12.Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 78 dhe 79,
  - 4.13.Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara me nenin 81,
  - 4.14.Nëse nuk e kryen aranzhimin profesional të artikujve nëpër vitrina, nuk i shkruan çmimet e artikujve me material të njëjtë, nuk e shpallë me shkrim orarin e punës fillimin dhe mbarimin e punës (neni 84),
  - 4.15.Nëse vërtetohet dhe vlerësohet nga ana e organit kompetent se lëshimi i lejes për rrëmihje dhe evitimin e prishjeve nga neni 110 paragrafi 1 nuk ka qenë i natyrës urgjente (neni 110.3),
  - 4.16.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 112,
  - 4.17.Nëse me rastin, kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 , paragrafi 1,2,3 dhe 4.
5. Për kundërvajtje nga neni 5 deri 22 dhe neni 30, 33, 34, 35, 46, 56, 61, 69, 71, 81, 87, 110, 112, 141, dhe 151 të kësaj rregulloreje do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej 25€ edhe personi përgjegjës i personit juridik nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tij.

**Neni 154**  
**Sanksionet e lehta kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **10€ deri 100€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik,
2. Dënohen me gjobe në shumën prej **30€ deri 250€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual,
3. Dënohen me gjobë në shumën prej **100€ deri 1.500€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 11 dhe 12;
  - 4.2.për shkak të lidhjes me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa leje (neni 17);
  - 4.3.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 22 dhe 36;
  - 4.4.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 47, 48, 49, 50, 52, 53, 57, 60;
  - 4.5.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 70,72,73,75,76;
  - 4.6.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 80 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 82;
  - 4.7.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 66 paragrafi 1 dhe 2;
  - 4.8.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 86,88 dhe 90;
  - 4.9.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94, 95 paragrafi 1,2,3 dhe 4;
  - 4.10.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 96;
  - 4.11.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 119;
  - 4.12.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 111, 112, 113, 114, 117;
  - 4.13.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara nga neni 123;
  - 4.14.nëse nuk sillet në pajtim me nenin 124 dhe 125;
  - 4.15.nëse nuk e bënë shpëlarjen e rrugëve dhe pastrimin në pajtim me kontratën në mes të organeve përkatëse të administratës komunale dhe ndërmarrjes punuese kompetente (neni 130,131);
  - 4.16.nëse nuk e siguron numrin e mjaftueshëm të enëve speciale dhe kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha hapësirat punuese dhe sipërfaqet e lira (neni 134);
  - 4.17.nëse vepron në kundërshtim me nenin 136 dhe 137;
  - 4.18.nëse nuk e bënë pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore, nëse nuk e spërkatë materialin e grimcuar gjatë rrënimit në mënyrë që mos të ngjitet pluhuri (neni 139);
  - 4.19.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 139;
  - 4.20.nëse nuk i përmbahet masave të përcaktuara nga neni 140;
  - 4.21.nëse kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 dhe 142;
  - 4.22.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 143,144,145, 146, 147, 148e 149;
  - 4.23.nëse nuk i respekton nenet 150 dhe 151;
  - 4.24.nëse gjatë qitjes së shenjës së komunikacionit “STOP-INSPEKTORATI” vozitësit e automjeteve të rënda nuk i ndalin dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara inspektorit (neni 153).
5. Për kundërvajtje nga neni 160 të nën-paragrafëve 1.11, 1.12, 1.13, 1.14, 1.15, 1.16, 1.17, 1.19, 1.20, 1.21, 1.22, 1.23 dhe 1.24 do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej **25€**

edhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tyre.

### **Neni 155** **Sanksionet e lehta kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **10€ deri 100€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik,
2. Dënohen me gjobe në shumën prej **30€ deri 250€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual,
3. Dënohen me gjobë në shumën prej **100€ deri 1.500€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1.pa lejen përkatëse bënë kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (neni 17),
  - 4.2.nëse bënë ndonjërrën prej veprimeve të ndaluara nga neni 36 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10,
  - 4.3.nëse bënë ndonjërrën prej veprimeve nga neni 53 paragrafi 1 deri 18,
  - 4.4.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 61,
  - 4.5.nëse vepron në kundërshtim me nenin 62 paragrafi 3, 4 dhe 5,
  - 4.6.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 70 deri 77,
  - 4.7.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 78, 79, dhe 80,
  - 4.8.nëse nuk vepron sipas vendimit të drejtorisë së inspektoratit, respektivisht nëse nuk i eviton mungesat në afatin e caktuar (neni 81),
  - 4.9.nëse nuk e eviton rrezikun nga rrënimi i objekteve i cili është rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të objekteve fqinjë dhe sigurinë në trafik (neni 82),
  - 4.10.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e (neneve 86, 87, 88 dhe 89)
  - 4.11.nëse bënë ndonjërrën prej veprimtarive të ndaluara nga neni 95
  - 4.12.nëse nuk e bënë dezinfektimin e njeve sanitare dhe gëlqerosjen e tyre të paraparë me nenin 101;
  - 4.13.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 104;
  - 4.14.nëse nuk u përmbahet masave të caktuara nga nenet 111, 112, 113, 114 dhe 117
  - 4.15.nëse bënë ndonjërrën prej veprimeve me të cilin nuk respektohet neni 126,
  - 4.16.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 141,
  - 4.17.nëse nuk respektohet neni 146,
  - 4.18.nëse bënë ndonjërrën prej veprimeve të ndaluara nga neni 149 nga pika 1 deri në pikën 26.
  - 4.19.nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal në “STOP-INSPEKTORI” vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara nga inspektori (neni 153).

**Neni 156**  
**Sanksionet e lehta kundërvajtëse**

1. Dënohet me gjobë në shumën prej **10€ deri 100€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës të personit juridik,
2. Dënohen me gjobe në shumën prej **30€ deri 250€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual,
3. Dënohen me gjobë në shumën prej **100€ deri 1.500€** për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
  - 4.1.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 35.
  - 4.2.nëse i shfrytëzon sipërfaqet publike të gjelbra jashtë destinimeve të tyre themelore pa leje nga organi kompetent (neni 46),
  - 4.3.nëse bënë ndonjërin nga veprimet e ndaluara nga neni 57 paragrafi 1 dhe 2,
  - 4.4.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 60,
  - 4.5.nëse bënë ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 70 paragrafi 1 dhe 2
  - 4.6.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 78,
  - 4.7.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 81 dhe 82,
  - 4.8.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94 dhe neni 95,
  - 4.9.nëse nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt në sipërfaqen e rrëmihur të paraparë sipas nenit 111,
  - 4.10.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 122,123 dhe 126,
  - 4.11.nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 129,130 dhe 134,
  - 4.12.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 140,
  - 4.13.nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 146,
  - 4.14.nëse bënë ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 150 pika 1 deri në 7,

**Neni 157**  
**Depozitat ndëshkimore për minorenët**

Për kundërvajtjet e caktuara me këtë rregullore, të cilat i bëjnë jo madhorët, të rinjtë, atëherë me gjobë do të dënohen prindërit e tyre, respektivisht kujdestarët.

**Neni 158**  
**Gjobat mandatore**

Për kundërvajtjet nga nenet: 36, 53, 59, 69, 87, 88, 103, 104, 105, 121, 122, 123, 124, 126, 127, 128, 129, 141, 144, 145,146, 147, 149, 150, 151 dhe 153, inspektorët komunal kanë autorizime të shqiptojnë dënime (gjoba) mandatore në shumë prej 50 € për persona fizik dhe persona përgjegjës të personit juridik.

## **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

### **Neni 159 Zbatimi i rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen Drejtoritë përkatëse, Ndërmarrjet Publike Komunale dhe Policia.

### **Neni 160 Konflikti, ndryshimi dhe plotësimi i rregullores**

1. Në rast se dispozitat e kësaj rregulloreje bie ndesh me dispozitat e ligjeve të aplikueshme do të vlejnë dispozitat e atyre ligjeve.
2. Për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje do të zbatohet procedurë e njëjtë me mënyrën siç është miratuar kjo rregullore. Zbatimi praktik i kësaj rregulloreje, mund të rishikohet dhe të iniciohet, ndryshimi dhe plotësimi i saj nëse është e nevojshme, pasi të ketë kaluar afati prej gjashtë (6) muajsh nga dita e miratimit të saj nga ana e Kuvendit të Komunës së Deçanit.
- 3.

### **Neni 161 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi 7 ditësh pas publikimit ne ueb-faqen e komunës .

01. nr. \_\_\_\_\_  
Vendi , më \_\_\_\_\_

**Kuvendi i komunës,**

\_\_\_\_\_  
**Kryesues**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



|                        |                                         |
|------------------------|-----------------------------------------|
| Dt.                    | 09.12.2022                              |
| Për/To/Za:             | Asamblesë Komunale z. Hajdar Sutaj      |
| CC:                    | Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj |
| Nga/From/Od:           | z. Besnik Hulaj - Drejtor i DKA-së      |
| Lënda/Subjekt/Subjekat | KËRKESË - PËLQIM                        |

Bazuar në kërkesat nga Këshillit Drejtues i Shkollës, punëtorëve të shkollës, kërkesës së Drejtorit të shkollës, dhe komunitetit të fshatit dhe shkresat tjera përcjellëse.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) NR. 102/2020 Emërtimi dhe Riemërimi i Institucioneve Publike Edukative-Arsimore, nga tre emrat e propozuar nga shkolla Rekomandojmë që Asambleja Komunale ta aprovojë kërkesën tonë, dhe të jap **PËLQIM**.

Nga SHFMU "Bajram Curri" në Strelc i Epërm ti ndërrohet emri dhe ti vendoset "**Haki Povataj**".

Haki Povataj i lindur në fshatin Strelc i Epërm, Komuna e Deçanit, në vitin 1975/76 emërohet drejtor i shkollës, paraprakisht ka punuar profesor i lëndës së Edukimit Fizikë.

Me 21.07.1992 policia serbe e mora nga zyra e tij dhe e dërguan ne stacionin policor ne Deçan, ku pas disa orësh ekzekutohet për mos dorëzimin e vulave të shkollës.


Për më shumë të dhëna për biografinë e profit z. Povataj (dëshmorë i kombit), i gjeni të bashkangjitur në kërkesën e DKA-së.


Jem të gatshëm për bashkëpunim lidhur më dokumente shtesë, që vendimi të jetë sa më meritore nga ana e juaj si institucion.

Andaj,

Kërkojmë nga titulli i lartpërmendur, që ta shqyrtojë kërkesën dhe shkolla ta merr emrin Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Haki Povataj" në Strelc i Epërm.

**Punë të mbarë!**





KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPŠTINA DEÇAN

SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT  
"BAJRAM CURRI"  
STRELLE I EPËRM



Nr.por.03-1802

Dt.23.06.2022

Për:Drejtori komunale të Arsimit-Deçan

Nga:Shkolla fillore dhe emesme e ulët "Bajram Curri"Strelle i Epërm

Lënda:

K Ë R K E S Ë

Për ndrrimin e emrit të shkollës

Këshilli i shkollës dhe Këshilli i arsimtarëve me kërkesën e familjës Povataj në mbledhjen e vet të mbajtur mori vendim për ndrrimin e emrit të shkollës fillore dhe e mesme e ulët "Bajram Curri"me me keto propozime:

- 1."HAKI POVATAJ"- dëshmor
- 2."LIRIJA"
- 3."SHKENDIJA"

Me emrin e drejtorit të shkollës,dëshmorit "Haki Povataj"që dha jetën për mbrojtjen e shkollës shqipe,ishte shtyllë e kombit që ju bashkangjit shumë dëshmorve të tjerë që mbrojtën shkollën shqipe.

Është hero i ditëve tona dhe unanimisht perkrahim kërkesën e familjës edhe kesaj here për ndrrimin e emrit të shkollës.

Më datën, 12.07.2012 ne si organe udhëheqse të shkollës morem te njejtin vendim për ndrrimin e emrit te shkollës por ky propozim i shkollës dhe DKA-së u refuzua nga MASHT-i Vendim nr.3307 të dates, 20.09.2012 me arsyetimin që si kërkesë të paarsyshme heqjen emerit të patriotit të madh Bajram Curri dhe pse e çmojmë lartë kontributin e dëshmorit të kombit Haki Povataj. Me arsyetim që ekzistojnë menyra të ndryshme për të shprehur respekt për vepren e tij të madhe.


Mbesim me shpresë që kerkësa e shkollës kesaj here te miratohet.

Strelle i Epërm



Drejtori i shkollës

*Bashkim Berisha*  
Bashkim Berisha





SHFMU "Bajram Curri" Strellc i Epërm  
Këshilli Drejtues i Shkollës

Datë: 24/06/2022

Nr. Prot. 03/1865

Në takimin e mbajtur sot me 24/06/2022 u diskutua rreth iniciativës së familjës së dëshmorit Haki Povataj nga Strellci i Epërm, ish mësimdhënës dhe drejtori i parë i shkollës i kindapuar në shkollë dhe ekzekutuar nga forcat serbe në vitin 1992, e përkrahur edhe nga kolektivi i shkollës për ndrrimin e emrit të shkollës se tashme "Bajram Curri" në atë të bashkëvendësit tonë i cili tër qenjën ja kushtoi shkollës dhe luftës për lirin e Kosovës Haki Povataj !

KDSH duke njohur fort mirë punën shumëvjeqare dhe heroizmin e Haki Povataj si dhe duke mbështetur dhe përkrahur iniciativën e marrë edhe nga kolektivi i shkollës, njëzëri përkrahu këtë iniciativë dhe shpreson që organet përgjegjëse do ta marrin në konsideratë dhe do të lejojnë zëvendësimin e emrit të shkollës.

KDSH i shkollës në asnjë rrethanë nuk hedhë poshtë emrin e tanishëm të shkollës por mbështetur në faktin që shumë shkolla në Kosovë dhe ma gjërë mbajnë emrin e patriotit tonë kombëtar Bajram Curri.

KDSH shpreson që organet kompetente të emrimeve të shkollave, veqsa do ta ndërojnë jo vetëm fshatin por edhe komunën dhe Republikën e Kosovës për të cilën dha jetën edhe vetë Haki Povataj!

Lavdi deshmoreve të Kombit!

Me respekt KDSH!

Këshilli Drejtues i Shkollës:

Kryetar: Dervish Hasanramaj

Z.kryetar: Nderim Povataj

Antar :nga Komuna

Bujar Istrefaj

Antar : Mësimdhënës

Agim Avdimetaj

Antar : Mësimdhënës

Hatmone Malaj

KNSH:

Arleta Hasanmetaj

Sekretar :Drejtori

Bashkim Berisha

Strellc i Epërm

24/06/2022



Kryetari KDSH:

Dervish Hasanramaj

DREJTUAR MINISTRISË SË ARSIMIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS

NGA

KRYESIA E FSHATIT STRELLC I EPËRM – KRYETARI

LËNDA:

**KËRKESË**

*(për vendosjen e emrit të deshmorit Haki Povataj në Shkollën Filllore  
"Bajram Curri" - Strellc i epërm).*


Ne, Kryesia e Fshatit Strellc i Epërm kërkojmë nga institucionet kompetente të Arsimit të Republikës së Kosovës që të marrin parasysh kërkesën e fshatit për ndërrimin e emrit të shkollës nga "**Shkolla Filllore Bajram Curri**" të cilin emër e kishte vendosur vet dëshmori Haki Povataj në "**Shkolla Filllore Haki Povataj**" pasi që Haki Povataj ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e arsimit shqip.

Prandaj ne si fshat kemi vendosur që për kontributin dhe sakrificën që ka dhënë **Haki Povataj** ta nderojmë shkollën tonë me emrin e tij.

**Haki Povataj** ishte drejtori i Shkolles fillore në Strellc si dhe drejtor i arsimit të komunës së Deçanit në variantin C të mësimit (mësimi nëpër shtëpi private) deri në momentin kur okupatori serb e arreston dhe e vret dhe ai bie deshmor duke mos e dorëzuar vulën dhe dokumentacionin me mbishkrimin "**Republika e Kosovës**".

Strellc i Epërm 07.07.2022

Kryetari i fshatit



Sali Rustemaj



Nr.por.03-1801

Datë:23.06.2022

Lista emrore e punëtorve të SHFMU "Bajram Curri" në Strelle i Epërm-Deçan  
Për ndrrimin e emrit të shkollës

| Nr. | Emri Mbiemri i punëtorit | Vendi i punës       | Nënshkrimi                 |
|-----|--------------------------|---------------------|----------------------------|
| 1.  | Bashkim Berisha          | Drejtor             | <i>Bashkim Berisha</i>     |
| 2.  | Zyrafete Nuraj           | Sekretare           | <i>Z. Nuraj</i>            |
| 3.  | Ismet Milaj              | Mësimdhenës lëndor  | <i>Ismet Milaj</i>         |
| 4.  | Hyse Milaj               | Mësimdhenëse        | <i>Hyse Milaj</i>          |
| 5.  | Arjeta Hoxhaj/Daci       | Mësimdhenëse        | <i>Arjeta Hoxhaj</i>       |
| 6.  | Durim Balaj              | Mësimdhenës         | <i>Durim Balaj</i>         |
| 7.  | Denis Osaj               | Mësimdhenës         | <i>Denis Osaj</i>          |
| 8.  | Adrijana Binakaj         | Mësimdhenëse        | <i>Adrijana Binakaj</i>    |
| 9.  | Gani Malaj               | Mësimdhenës         | <i>Gani Malaj</i>          |
| 10. | Agim Avdimetaj           | Mësimdhenës         | <i>Agim Avdimetaj</i>      |
| 11. | Hatmone Malaj            | Mësimdhenëse        | <i>Hatmone Malaj</i>       |
| 12. | Sami Avdimetaj           | Mësimdhenës         | <i>Sami Avdimetaj</i>      |
| 13. | Rasim Avdimetaj          | Mësimdhenës         | <i>Rasim Avdimetaj</i>     |
| 14. | Xhavit Ramosaj           | Mësimdhenës         | <i>Xhavit Ramosaj</i>      |
| 15. | Ismet Lokaj              | Mësimdhenës         | <i>Ismet Lokaj</i>         |
| 16. | Vjosa Bajra              | Mësimdhenëse klasor | <i>Vjosa Bajra</i>         |
| 17. | Mone Dobraj/Bricori      | Mësimdhenëse        | <i>Mone Dobraj</i>         |
| 18. | Teuta Alimusaj           | Mësimdhenëse        | <i>Teuta Alimusaj</i>      |
| 19. | Afrore Gjukaj            | Mësimdhenëse        | <i>Afrore Gjukaj</i>       |
| 20. | Kumrije Idrizaj          | Mësimdhenëse        | <i>Kumrije Idrizaj</i>     |
| 21. | Leonite Hajdaraj         | Mësimdhenëse        | <i>Leonite Hajdaraj</i>    |
| 22. | Fatime Shabanaj          | Mësimdhenëse        | <i>F. Shabanaj</i>         |
| 23. | Suzana Avdimetaj         | Mësimdhenëse        | <i>Suzana Avdimetaj</i>    |
| 24. | Samire Pajazitaj         | Mësimdhenëse        | <i>Samire Pajazitaj</i>    |
| 25. | Anita Avdimetaj/Berisha  | Mësimdhenëse        | <i>Anita Avdimetaj</i>     |
| 26. | Naser Hasanramaj         | Mësimdhenës         | <i>Naser Hasanramaj</i>    |
| 27. | Miftar Nuraj             | Punëtor teknik      | <i>Miftar Nuraj</i>        |
| 28. | Shkelzen Hasanmetaj      | Punëtor teknik      | <i>Shkelzen Hasanmetaj</i> |
| 29. | Idriz Halilaj            | Punëtor teknik      | <i>Idriz Halilaj</i>       |
| 30. | Fatmir Povataj           | Punëtor teknik      | <i>Fatmir Povataj</i>      |
| 31. | Valon Idrizaj            | Punëtor teknik      | <i>Valon Idrizaj</i>       |

Strelle i Epërm



Drejtori i shkollës

*Bashkim Berisha*  
Bashkim Berisha

## Biografi e shkurter për dëshmorin Haki Povataj

Haki Povataj u lind në fshatin Strelle të Epërm.

Hakiu rrjedhë nga nje familje e ndershme fshatare dhe patriotike.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndesa te mesmën në Prizren.

Pas mbarimit të shkollës SHLP emrohet arsimtar i lëndës ed.fizike në shkollën fillore “Lrija” në Isniq në paralelen e ndarë ne Strelle të Epërm.

Hakiu ishte dashamir i dijes dhe i posporitetit,merrej me punë krijuse,kurrë se kerkoji punën puna dhe vendi e kerkonte ate si te tillë.

Në vitin 1975/76 emrohet drejtor i shkollës fillore “Bajram Curri” në Strelle të Epërm.

Ky kishte një energji te mbrendshme,një forc e vullnet të pa thyeshëm,ndonse shoket e këshillonin te pushonte pak,sepse puna e bente te vetën.

Kishte qellim te lartë rrugë të qartë donte ta mposhte çdo veshtersi.

Diti ta mobilizonte tere potencialin intelektual e te vyeshem te shkollës.

Nga natyra ishte i dashur,i afert i përzemret i durushëm por edhe i rrembyshëm dhe teper i ndishëm për qeshtjet madhore,kishte guximin e trimrinë,kur e donte nevoja por çdohere me maturi e mençuri.

Te gjitha keto veçori e virtyte e benë prind te dashur dhe te respektuar,shok e koleg te mirë,shqiptar te fort,por edhe intelektual me vizion te gjerë.

Për guximin që kishte treguar në Lëvizjen e viteve të 90-ta dhe për sukseset që kishte treguar në udhëheqjen e shkollës fillore “Bajram Curri” në Strelle të Epërm,Haki Povataj ishte vënë në ballor të udhëheqjes së arsimit shqip në komunë.Ai kishte marr guximin edhe për nxjerrjen e vulave të para me mbshkrimin “Republika e Kosovës”,sikurse edhe shumë veprimtari të tjera që të mbijetoj shkolla shqipe përballë një regjimi të egër.Patrioti Haki Povataj i kishte vënë në përdorim këto vula,duke treguar tashmë botërisht se një epokë e re po vinte në këto troje të gjakosura për më shumë se 100 vjet historie.Nuk ka dyshim se ky guxim dhe veprimet e tjera kundër regjimit serb.

Haki Povataj ka qenë njëri i cili nuk ka kursyer asgjë nga vetja e tij,në të mirë të arsimit shqip,ani pse gjithmonë i dinte rreziqet e mundshme në atë kohë ai atë kohë ai nuk u orzua deri sa edhe edhe u flijua për arsimin shqip.

Në oborrin e shkollës fillore të mesme të ulët “Bajram Curri” në Strelle të Epërm,gjendet busti i dëshmorit Haki Povataj do ta kujtojmë si pishtarë i arsimit,si njëri që gjithë jetën ja ka kushtuar kombit dhe arsimit shqip.

Punën dhe veprimtarin e tij e nderprën forcat policore serbe në vitin 1992.

Me 21.07.1992 policia serbe e mori nga zyra e tij dhe e derguan në stacionin e policor në Deçan ku pas disa orësh ekzekutohet për mos dorzimin e vulvae te shkollës.

Hakui nuk e pati fatin ta përjetojë lirinë e Kosovës, ndonse në shpirtin e tij asnjehere nuk e pranoi roberin.

Me Hakium nuk krenohet vetem fshati e qyteti dhe as vetem shteti i Kosovës, sepse vepra e tij heroike shkon edhe përtej saj.

Renja për liri është veper sublime e nje njeriu.

Te gjithë dëshmoret kanë nje emrues te përbashket sepse janë njësoi te mëdhenj te barabart.

Strelc i Epërm



Drejtori i shkollës

*Bashkim Berisha*  
Bashkim Berisha

## BIOGRAFIA E SHKURTER PËR PROPOZIMIN E EMRIT TE "SHKOLLËS" LIRIJA"

Populli shqiptar ndershekuj gjakoji lirinë dhe mvetësinë.  
Në altarin e betejave ushtarake dhe politike për këtë qellim të lartë njerzor u  
varguarn heronj, dëshmor, tribun e njerz të rendomtë, duke e mbajtur gjallë  
çeshtjen shqiptare, e cila as sot nuk e ka marrë perkufizimin e vet të  
natyrshem.

Luftërat e pa numerta kunder okupatoreve të Sojeve e gjakpirësive të  
ndryshme, lidhje të shumta ushtarake, politike dhe kombetare vendimet e  
rezultatet e shumta përhere kanë pasur dhe kanë cak mbylljen njëhere e  
mirë, pra zgjidhjen definitive të çeshtjes shqiptare në Ballkan gjithmon të  
trazuar nga forcat e errta të hegjemonive dhe politikave imperialisteve të  
fqinjëve të afert dhe atyre me të largët.

Nga radhet e keti populli dolen individ që i dhane fuqi, nxitje, insprim dhe  
energji kesaj qendrese dhe mbijeteses sonë të UQK-se manifestoj idealet dhe  
synimet sublime për liri dhe shtet formesi.

Ne sot gezojm lirinë fal dëshmoreve që dhanë jetën për liri.

Strelci i Epërm



Drejtori i shkollës

*Bashkim Berisha*  
Bashkim Berisha

## BIOGRAFIJA E SHKURTER PËR PROPOZIMIN E EMRIT TE SHKOLLËS" SHKENDIJA"

Lufta për liri bashkoi te gjithë shqiptaret pa dallim feje dhe krahine.  
Në qytetin e bukur te Prizrenit u mblodhen përfaqses nga te gjitha viset shqiptare.

Ata formuan Lidhjen Shqiptare te Prizrenit.

Kryetar i lidhjes u zgjodh Iliaz pashë Dibra.Në këtë kohe,tokat shqiptare ishin te pushtuara nga perandoria osmane dhe nga forcat tjera.

Përpyekjet e shqiptareve në luftë kunder pushtuesve kishin për synim çlirimin përfundimtar nga okupatori dhe ky popull per ti pare shkendijat e dritës dhe per tu larguar nga errsira shekullore.


Ne këtë kohe jeta e njerzeve nuk ishte shumë e lehtë.

Sot ky popull gëzon lirinë falë gjakut te dëshmoreve që dhanë për këtë vend.

Strelle i Epërm



Drejtori i shkollës

  
Bashkim Berisha



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**  
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA E DEÇANIT**  
**MUNICIPALITY OF DEÇAN**  
**OPSTINA DEÇAN**



# **RAPORT**

**ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

**KOMUNA DEÇAN**

**Hartues të raportit:**

Ajne Iberhysaj

**Deçan, 2022**

## Përmbajtja

|                                                   |                                     |
|---------------------------------------------------|-------------------------------------|
| HYRJE .....                                       | 3                                   |
| QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT .....            | 4                                   |
| METODOLOGJIA.....                                 | 5                                   |
| PROCESET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE ..... | 5                                   |
| AUDITIMI I BRENDSHËM .....                        | 6                                   |
| MEKANIZMI I ANKESAVE.....                         | 6                                   |
| LAJMËRIMI DHE RAPORTIMI I KORRUPCIONIT .....      | 7                                   |
| KULTURA ORGANIZATIVE.....                         | 7                                   |
| PËRKUSHTIMI I UDHËHEQËSISË SË KOMUNËS .....       | 7                                   |
| KODI I ETIKËS.....                                | 7                                   |
| INTEGRITETI .....                                 | 8                                   |
| KONFLIKTI I INTERESIT .....                       | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |
| RREZIQET E INTEGRITETIT .....                     | 8                                   |
| KOMUNIKIMI DHE INFORMACIONI.....                  | 9                                   |
| KONKULZIONE DHE REKOMANDIME .....                 | 10                                  |

## **HYRJE**

Plani i Integritetit është dokument strategjik dhe operativ që ka rezultuar nga procesi i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë brenda Komunës së Deçanit. Plani i Integritetit rritet për përkushtimin e komunës për të përmirësuar edhe më tej kontrollet ekzistuese operative në të gjithë spektrin e aktiviteteve të kryera, me fokusim në ofrimin e shërbimeve transparente, efikase dhe që kanë qytetarin në qendër të vëmendjes. Plani i integritetit i përshkruan masat e bazuar në rrezik për arritjen e objektivave të veta të integritetit dhe për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale.

Ky plan konsiderohet pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme planifikuese të komunës, që ndërlidhen me planin strategjik për zhvillim institucional, i cili shton aspektin e menaxhimit të rrezikut. Në nivel më të gjerë, ai plotëson implementimin efektiv të Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit të Komunës së Deçanit, në pjesën që ka të bëjë me qeverisjen lokale. Përmes implementimit të këtij Plani të Integritetit, komuna është në një pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektshmëri, transparencë dhe etikë. Plani i Integritetit përbëhet nga:

1. Regjistri i cënueshmërive të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
2. Plani i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të implementohen për të zvogëluar cënueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për implementim.

Në Dhjetor 2020, Kryetari i Komunës së Deçanit, ka publikuar Planin e Integritetit dhe miratoi masat për përmirësimin e integritetit për periudhën 2020-2022. Plani i Integritetit është në dispozicion për të gjithë të punësuarit në Komunën e Deçanit.

## **QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT**

Ky raport ka për qëllim matjen e zbatueshmërisë së Planit të Integritetit nga zyrtarët dhe udhëheqësi i Komunës së Deçanit, për vitin 2022. Për ta kryer matjen e zbatueshmërisë, raporti është fokusuar në matjen e faktorëve kryesor që e përbëjnë planin e integritetit. Faktorët kryesor të planit të integritetit janë si më poshtë:

### **1. ASPEKTET ORGANIZATIVE**

- a) Ndarja/shpërndarja e funksioneve/përgjegjësi
- b) Përshkrimi i vendit të punës dhe detyrave;
- c) Rezultatet në punë, ngritja në pozitë dhe rekrutimi;
- d) Auditimi i Brendshëm;
- e) Mekanizmi për ankesa publike;
- f) Mekanizmi i sinjalizuesit;

### **2. KULTURA ORGANIZATIVE**

- a) Kodi i mirësjelljes dhe lidërshipi etik;
- b) Lufta kundër korrupsionit;
- c) Konfliktet e interesit;
- d) Mos-përshtatshmëria e funksioneve;
- e) Dhuratat apo mikpritja;

### **3. RREZIQET SPECIFIKE DHE CENUESHMËRITË**

- a) Vlerësimi i rrezikut të integritetit komunal;
- b) Fushat e thelbësore të funksioneve komunale;
- c) Aktivitetet specifike komunale;
- d) Administrata e përgjithshme komunale;
- e) Llojet e shkeljeve dhe praktikat e dyshuara në aspektin etik.

### **4. PROKURIMI**

- a) Drejtësia dhe transparenca e sistemit të prokurimit;

### **5. KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI**

- a) Komunikimi;
- b) Informimi;

## METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti, me autorizimin e kryetarit të komunës, është caktuar zyrtari raportues. Zyrtari është i autorizuar për të përcaktuar natyrën e raportit, për të identifikuar treguesit kryesor që e masin zbatueshmërinë e Planit të Integritetit, përpilimin e pyetësorëve, analizimin e të dhënave, interpretimin e tyre dhe prezantimin e raportit para asamblesë komunale.

### **Procesi i realizimit të raportit**

- Si hap i parë është kryer identifikimi i treguesve që e masin zbatueshmërinë e Planit të Integritetit. Për identifikimin e treguesve është marrë për bazë plani i integritetit ku janë të përfshirë të gjithë treguesit;
- Në hapin e dytë janë nxjerr treguesit dhe është krijuar lista e treguesve;
- Në hapin e tretë janë shpërndarë pyetësorët nëpër drejtori dhe janë intervistuar zyrtarët publik;
- Në hapin e katërt, raporti është, shqyrtuar dhe përgatitur për raportin.

## PROCESET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Sipas anketës së zhvilluar me shërbyesit publik rezulton se:

*2% e zyrtarëve të komunës mendojnë se nuk zbatohen procedurat dhe proceset e prokurimit në përputhje me ligjin;*

*12% e tyre janë skeptik për proceset e rekrutimit*

*21% e tyre nuk duan të japin mendim;*

*65% e zyrtarëve mendojnë se procedurat dhe proceset e rekrutimit të punonjësve publik kryhen në përputhje me ligjet.*

---

*72% e zyrtarëve të komunës mendojnë se përzgjedhja e punonjësve bëhet sipas meritës;*

*28% kanë mendime skeptike duke mos besuar fare apo mendojnë se ndikojnë faktorë tjerë.*

### **Si indikator i rëndësishëm është edhe procesi i shpërblimeve të zyrtarëve:**

*3% e zyrtarëve mendojnë se sistemi aktual i shpërblimeve nuk është transparent;*

*17% nuk mund të japin ndonjë gjykim;*

*5% e tyre mendojnë se nuk është plotësisht transparent;*

*75% mendojnë se është transparent;*

---

*8% mendojnë se trajnimet dhe menaxhimi i burimeve njerëzore nuk janë mjaftueshëm të drejta;*

*10% e tyre nuk besojnë në të gjitha proceset për organizimin e trajnimeve;*

*20% nuk janë të gatshëm të japin mendim për këtë qësjtje;*

*62% mendojnë se proceset për trajnimin e punonjësve janë të drejta.*

## AUDITIMI I BRENDSHËM

### **Sipas zyrtarëve të komunës të cilët janë anketuar, kryetari i komunës a ka përkushtim të kufizuar për ushtrimin e një kontrolli të brendshëm, rezulton se:**

- 4% e respondentëve thonë se ka vetëm fjalë por jo vepra;*
- 1% mendojnë se udhëheqësit veprojnë në mënyra selektive;*
- 35% nuk janë të gatshëm të japin mendim;*
- 60% mendojnë se udhëheqësi i komunës është shumë i përkushtuar.*

### **Për sa i përket profesionalizmit të zyrës së Auditorit të Brendshëm:**

- 3% e zyrtarëve nuk besojnë në kompetencat e tyre apo nuk dinë mjaftueshëm për Auditimin e Brendshëm dhe rrjedhimisht nuk e konsiderojnë efikas për të zbuluar shkeljet e integritetit;*
- 97% e zyrtarëve të komunës besojnë se Auditimi i Brendshëm mundëson zbulimin e shkeljeve të integritetit;*

- 
- 97% e zyrtarëve janë në dije për punën e Auditimit të Brendshëm dhe i janë nënshtruar inspektimeve të tyre;*
  - 3% e tyre nuk kanë dijeni për një inspektim të tillë dhe nuk i janë nënshtruar inspektimeve të Auditimit të Brendshëm.*

### **Për hapat e përmirësimit të situatës ka mendime të ndara të cilat rezultojnë si në vijim:**

- 4% e zyrtarëve nuk kanë dijeni nëse janë marrë hapa për të korrigjuar sistemet dhe praktikatat e gabuara në qeverisjen e komunës;*
- 1% mendojnë se nuk është ndërmarrë asnjë masë;*
- 15% mendojnë se merren masa kohë pas kohe në mënyrë selektive;*
- 80% e zyrtarëve pohojnë se janë marrë masa korrigjuese në vazhdimësi.*

## MEKANIZMI I ANKESAVE

### **Përgjigjet e të anketuarve tregojnë se:**

- 8% e zyrtarëve nuk e dinë nëse komuna ka ndonjë mekanizëm të pavarur për ankesa brenda komunës për qështje të integritetit;*
- 5% janë të bindur se nuk ka;*
- 75% pohojnë se ka mekanizëm për ankesa;*
- 12% e tyre mendojnë se një mekanizëm i tillë nuk është fare i dobishëm.*

### **Sa i përket raportimit të rasteve të korrupsionit në komunë sipas procedurave të caktuara nga komuna, zyrtarët kanë mendime të ndara:**

- 53% e tyre nuk kanë njohuri fare dhe nuk e dinë nëse raportohen apo jo rastet e korrupsionit;*
- 3% mendojnë se nuk përfillen procedurat;*
- 3% mendojnë se përfillen pjesërisht;*
- 41% pohojnë se ato përfillen plotësisht.*

## **LAJMËRIMI DHE RAPORTIMI I KORRUPCIONIT**

**Ky faktor është matur duke u bazuar në treguesit si: aktet normative, mbrojtja e sinjalizuesve dhe bashkëpunimi. Sipas rezultateve të arritura nga anketa e realizuar me zyrtar të komunës del se:**

*40% e zyrtarëve nuk e dinë nëse ka ndonjë procedurë të brendshme për paraqitjen e korrupsionit;*

*5% janë të bindur se nuk ka;*

*55% pohojnë se ka procedura për lajmërimin e korrupsionit;*

**Hulumtimi në vazhdim tregon se:**

*2% e zyrtarëve mendojnë se në komunë nuk ka kushte për ta raportuar lirshëm korrupsionin,*

*8% mendojnë se mundet të lajmërohet sipas ligjit,*

*80% mendojnë se ka kushte për ta lajmëruar korrupsionin;*

*10% nuk kanë ndonjë opinion në këtë drejtim.*

## **KULTURA ORGANIZATIVE**

**Sipas anketës së realizuar dalin nga te anketuarit këto rezultate:**

*42% të zyrtarëve të intervistuar kuptohet se për luftimin e korrupsionit nuk mbahen trajnime;*

*12% e tyre pohojnë se nuk trajtohet asnjëherë;*

*34% e zyrtarëve kanë pohuar se kjo qështje trajtohet shpesh;*

*12% nuk kanë ndonjë mendim në këtë pike;*

## **PËRKUSHTIMI I UDHËHEQËSISË SË KOMUNËS**

**A kanë njohuri zyrtarët komunal se mekanizmat shtetëror kanë përkushtim të qartë për të fuqizuar integritetin e pushtetit lokal:**

*11% e tyre nuk kanë qenë të gatshëm të japin një mendim;*

*46% janë të qartë se mekanizmat shtetëror nuk janë të përkushtuar për ofrimin e luftimit të korrupsionit;*

*43% mendojnë se po ka përkushtim të pjeserishëm.*

## **KODI I ETIKËS**

**Njohurit e zyrtarëve komunal rreth Kodit të Etikës dhe zbatueshmerisë së tij:**

*82% e zyrtarëve komunal janë në dijeni se komuna ka një kod të etikës;*

*3% nuk e dinë se komuna e ka këtë dokument;*

*15% e tyre nuk janë të gatshëm të pohojnë e as të mohojnë;*

**Në pyetjen nëse kodi i mirësjelljes respektohet nga punonjësit e komunës del se:**

*55% e zyrtarëve nuk kanë ndonjë mendim për këtë qështje;*

*7% thonë se respektohen vetëm disa dispozita;*

*38% mendojnë se zbatohet në përpikëri.*

## INTEGRITETI

Për zbatimin e dokumenteve normative është e domosdoshme që punonjësit të trajnohen dhe të ngritët vetëdija e tyre për rëndësinë e tyre.

**A kanë ndjekur trajnime që kanë të bëjnë me integritetin, nga mekanizmat e nivelit qendror dhe si e vlerësojnë zyrtarët komunal domosdoshmërinë e këtyre trajnimeve:**

*97% e zyrtarëve komunal nuk kanë ndjekur trajnim për integritetin;*

*3% e tyre kanë deklaruar se kanë ndjekur trajnim;*

**Kur janë pyetur zyrtarët nëse ka apo jo rregulla që ndërlidhen me integritetin:**

*52% nuk kanë dijeni nëse ka rregulla dhe procedura;*

*7% janë të bindur se nuk ka rregulla;*

*41% mendojnë se ka dhe ato zbatohen.*

**Për pranimin e dhuratave nga personat e jashtëm të emëruarit:**

*52% e zyrtarëve nuk kanë njohuri nëse ekziston apo jo një rregullore për pranimin e dhuratave;*

*10% janë të bindur se nuk ka;*

*38% pohojnë se janë në dijeni se ka një rregullore të tillë;*

**A e ekziston një evidence për pranimin e dhuratave, zyrtarë komunal japim këto mendime:**

*90% e zyrtarëve nuk kanë njohuri nëse ekziston apo mbahet ndonjë evidence ku regjistrohen dhuratat e pranuar;*

*4% janë të bindur se nuk ekziston një regjistër i tillë;*

*6% pohojnë se kanë njohuri dhe ekziston një evidence.*

## RREZIQET E INTEGRITETIT

Në këtë hulumtim janë matur edhe rreziqet që shfaqen gjatë zbatimit të Planit të Integritetit. Kjo matje shërben për t'i kuptuar shkaktarët dhe efektet dhe gjetjen e mundësive për ti menaxhuar më mirë në të ardhmen. Për përmirësimin e integritetit për forcimin e qëndrueshmërisë operative ndaj shkeljeve të integritetit dhe për zvogëlimin në mënyrë efikase të rreziqeve të ndërlidhura, përgjegjësia bie mbi këto njësi administrative: Administrata komunale, Rregulloret,, Transparenca në vendimmarrje.

**Anketimi dhe rezultatet e këtij hulumtimi me zyrtarët komunal paraqitet si në vijim:**

*45% e zyrtarëve të anketuar besojnë se plani i integritetit dhe rregulloret në fuqi janë të dobishme;*

*27% nuk kanë mendim të qartë;*

*28% nuk janë të bindur në cilësinë e rregulloreve.*

Sipas zyrtarëve, të përfshirë në këtë hulumtim, për ta mbrojtur planin e integritetit nga shkeljet, mekanizmat shtetëror duhet të ofrojnë trajnime adekuate për zyrtarët e komunës të

cilat deri tani nuk janë ofruar. Masat e rekomanduara nga të anketuarit janë: organizimi i trajnimeve, punëtorive, raporteve dhe koordinimi me të gjitha njësitë komunale.

**Në lidhje me shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe për parandalimin e shkeljeve të integritetit:**

*36% mendojnë se ka rregullore që e rregullon shpërndarjen e informacionit konfidencial;*

*30% mendojnë se nuk ka;*

*34% e zyrtarëve nuk kanë mendim lidhur me këtë qështje.*

**KOMUNIKIMI DHE INFORMACIONI**

**Komunikimi dhe informacioni janë faktorë të domosdoshëm në zbatueshmërinë e Planit të Integritetit, mirëpo për këta faktor rezultojnë këto të dhëna:**

*52% e zyrtarëve të komunës mendojnë se politikat dhe praktikat e komunikimit në komunë nuk janë në nivelin e duhur;*

*26% kanë nevojë për informim për politika dhe praktika të komunikimit;*

*22% e tyre nuk kanë ndonjë mendim.*

**Nëse kjo situatë është krijuar sepse nuk ka presion nga qytetarët për këtë qështje. Sipas zyrtarëve të anketuar:**

*38% mendojnë se qytetarët nuk paraqesin ankesa për mënyrën e komunikimit të komunës;*

*40% e tyre nuk kanë ndonjë mendim për këtë qështje;*

*22% mendojnë se ka qytetarë që ankohen.*

**Si përfundim, cili është roli i zyrtarëve në zbatueshmërinë e planit të integritetit, rezultatet paraqiten si në vijim:**

*13% e tyre tregojnë se nuk kanë asnjë rol në këtë qështje;*

*52% prej tyre tregojnë se kanë rol;*

*35% nuk janë të gatshëm të ofrojnë një përgjigje.*

## KONKULZIONE DHE REKOMANDIME

Raporti ka për qëllim pasqyrimin e zbatueshmerisë së planit të integritetit dhe matjen e nivelit të progresit për vitin 2022. Raporti ka matur opinionin e zyrtarëve publik në lidhje me zbatueshmërinë e planit të integritetit. Duke u bazuar në opinionin e zyrtarëve publik mund të përfundohet se progresi ka qenë modest në relacion me pritshmërinë.

Ky progres modest i shënuar në zbatueshmërinë e planit të integritetit vërehet pothuajse në të gjithë faktorët e matur. Progres në integritet konsiderohet fakti se në të gjithë faktorët pothuajse besojnë se iniciativat e komunës janë duke e përmirësuar cilësinë e qeverisjes komunale.

Sipas te anketuarve kjo punë mund të përmirësohet në të ardhmen mund të bëhet duke ju ofruar trajnime për zyrtarët gjegjes, duke zbatuar aktet normative në fuqi.

### **Rekomandime**

Për të përmirësuar zbatueshmërinë e planit të integritetit, komuna e Deçanit, respektivisht udhëheqësi i saj duhet ta rrisë përkushtimin në secilin departament.

Duhet të planifikohen trajnime dhe tryeza të vazhdueshme me zyrtarët komunal me temën e integritetit dhe të korrupsionit në komunë në mënyrë që zyrtarët të mbahen të informuar me informata të freskëta për situatën e integritetit në komunë.